



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal nga mbledhja e XLVII-të (dyzeteshtatë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 30 dhjetor 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; kurse munguan Fitim Muçolli; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Fatmir Gashi; Qendresa Haliti, kurse munguan Ilir Koprani; Tringa Sfishta.

Nga PDK, Endritë Murati; Mimoza Abdullahu; kurse mungoi Bashkim Sylja.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli., kurse mungoi Adnan Zymeri,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

*(Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Inspeksionit DI dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Administratës DA; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;)*

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar të pranishmëve punë të mbarë, konstatoi kuorumin, theksoi, pra prezent për momentin janë 25 anëtar/e të Kuvendit dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen, mirëpo para se të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës ju njoftoj se ashtu siç edhe jeni në dijëni në mbledhjen e kaluar të Kuvendit

Arjeta Abazi dhe Qendrim Softolli kanë dhënë dorëheqje nga funksioni këshilltar/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës. Mandej janë zhvilluar procedurat për zëvendësimin e tyre dhe në këtë aspekt më datë 23 dhjetor 2024 nga KQZ janë marrë vendimet nr.01/2289-2024 dhe nr.01/2290-2024 sipas të cilave zonja Qendresa Haliti dhe zotëri Fatmir Gashi janë emëruar anëtar/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës duke zëvendësuar ish anëtarët e Kuvendit që i ceka pak më parë. Edhe pse rekomandimet nga mbledhja e KPF-së u janë dërguar dhe sigurisht që keni mund të vëreni se është rekomanduar që në këtë seancë të Kuvendit, para se të fillojmë me punimet të bëhet betimi i solemn i anëtarëve të Kuvendit, andaj në këtë aspekt kërkohet që znj.Qendresa Haliti dhe

z.Fatmir Gashi të jepin betimin solemn para Kuvendit të Komunës, mirëpo paraprakisht kërkoj nga Komisioni për verifikimin e mandateve që paraprakisht të bëjë verifikimin e mandatit.

Pra në komision janë znj.Donjetë Sheqiri, znj.Sebastina Vokrri dhe znj.Endritë Murati, mirëpo sa po vërej unë tani prezentë për momentin është vetëm znj.Donjetë Sheqiri, kështu që mund ta zëvendësojmë ndonjëherë prej atyre që mungojnë në mënyrë që të vazhdohet me procedurë.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në përbërjen e komisionit në fjalë në emër të Grupit LVV propozoj Drita Pajazitin në vend të Sebastina Vokrri edhe pse kjo e fundit veç sa nuk ka mbërri në sallë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë mund të vazhdojmë me punë dhe të bëhen përgatitjet deri sa dy anëtarët e komisionit në fjalë (Donjetë Sheqiri dhe Sebastina Vokrri) që tani janë prezentë, të jenë të gatshme të bëjnë verifikimin e mandatit të të përmendurve dhe të paraqesin raport të shkurtër rreth këtij procesi.

*Nga Komisioni për verifikimin e mandateve fillohet me punë, dhe në emër të Komisionit paraqitet raporti si në vijim:*

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, në emër të komisionit për verifikimin e mandateve konstatojmë që Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve ka marrë vendim dhe të gjitha dokumentet janë në rregull që të bëhet emërimi i Fatmir Gashit dhe Qendresa Halitit anëtar/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, andaj mund të vazhdohet tutje me procedurë duke i'u uruar dhe dëshiruara shumë suksese.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pas verifikimit të mandatit, konsideroj se tani gjithçka është në rregull, andaj ftoj znj.Qendresa Haliti dhe z.Fatmir Gashi të ngritën në këmbë dhe të japin betimin solemn, mirëpo paraprakisht sqaroj se unë e lexoj pjesë pjesë tekstin e betimit, kurse ju e përsëritni me zë, me të vetmin ndryshim që në fillim të tekstit ju e cekni emrin dhe mbiemrin tuaj.

Pra nëse jeni gatim fillojmë:

*“Unë, (duke theksuar emrin dhe mbiemrin e tyre personal), betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, urime, tani mund ta nënshkruani deklaratën e betimit dhe me këtë akt nga tani jeni anëtarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë, dhe njëkohësisht ju ftoj ta bëni deklarinimin e pasurisë.

## **Rendi i Ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani vazhdojmë me rendin e ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, të nderuar ju me kohë veç jeni pajisur me materialin e Draft Planit të qëndrueshëm urban në Komunën e Podujevës, mirëpo unë sot kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për arsye se ky draft Plan është hartuar nga një komision përkatës para muajit nëntor të këtij viti përderisa po në këtë muaji kanë pësuar disa ndryshime ligjore e që një pjesë e kornizës ligjore e cila është baza ligjore e këtij Plani e që ka pësuar ndryshime që janë Ligji për komunikacionin rrugor i cili në muajin nëntor është ndryshuar, andaj në mënyrë që të kemi një Plan sa më të mirë, pa gabime dhe pa defekte ligjore, andaj kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës. Komisioni përkatës është i gatshëm që të vazhdoj punën dhe pas

rishikimit të plotë të këtij Draft Plani do të na sillt neve si Drejtori dhe Ekzekutiv e i cili pastaj do t'ju dërgohet edhe juve si Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pas kësaj kërkesë të drejtorit parafolës, e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Ta kemi të qartë se për propozime në rend të ditës sipas Rregullores nuk ka diskutime. E kemi edhe zyrën ligjore këtu dhe mund të na jap sqarime.

**z.Naim Çunaku**, kërkon t'i jepet fjala që në emër të Grupit të paraqes deklaram rreth propozimit të drejtorit parafolës në mënyrë që të orientoj Grupin se si të voton. *(del në foltore)*

Vazhdon duke i reaguuar Kryesuesit se kush është zyra ligjore për Kuvendin e Komunës, çka ka kjo zyrë punë me Kuvendin, nuk mund të vazhdohet kjo formë nga ana e Kryesuesit të Kuvendit duke mu cenuar fjala ime që të prononcohem për këtë pikë të rendit të ditës dhe propozimin e drejtorit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, nuk mund ta marrësh fjalën në këtë mënyrë dhe po të lus të kthehesh në vend që të vazhdojmë me punë sepse kemi të bëjmë me një propozim të drejtorit të DSHPMSH që pika në fjalë të shtyhet për mbledhjen e radhës për arsyet që i ceku ai, andaj nuk kemi çfarë të diskutojmë këtu, vetëm ta hedhim në votim.

**z.Naim Çunaku**, sërish vazhdoi nga foltorja e Kuvendit duke theksuar se nuk shkoj në vend por do të qëndroj këtu në foltore dhe absolut nuk mund të vepros në këtë formë kështu duke ma cunguar të drejtën e fjalës që të prononcohem për pikën e rendit të ditës që u propozua sepse unë në emër të Grupit thërras dhe orientoj Grupin tim se si të votojmë.

Pra nuk shkoj nga këtu, dhe nuk mund ta bësh një gjë të tillë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ta keni të qartë se në bazë të Rregullores nuk lejohet debat në rend të ditës por çdo propozim vetëm hedhet në votim, prandaj nuk mund t'ia jap fjalën askujt.

Kemi një propozim për rend dite dhe nuk ka dhe nuk hapet debat, por vetëm hedhet në votim që të mbështetet apo jo, përndryshe lexojeni Rregulloren e punës së Kuvendit.

**z.Naim Çunaku**, sërish vazhdoi duke theksuar se për çdo propozim në rend të ditës duhet të deklarohen shifat e Grupeve dhe të thërrasin Grupin e tyre për të votuar ose jo.

Un për këtë pikë jam përgatitur dhe dua të diskutoj, madje kjo pikë e rendit të ditës i ka kaluar gjitha instancat duke përfshirë edhe KPF-në dhe ju nuk mund të më ndaloni tani mua të thërras grupin tim që të votoj për ose kundër, përndryshe ti zotëri Kryesues nuk mund të vazhdosh në këtë formë duke mos ma lejuar të marrë fjalën që të bëjë thirrje Grupit tim se si të votoj.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, çdo propozim del në votim dhe për propozime nuk ka debat, shikojeni Rregulloren e punës së Kuvendit e përcakton se për rend të ditës nuk ka debat ashtu siç nuk ka as për propozime për rend të ditës. Pra kemi një propozim për të hequr një pikë nga rendi i ditës, ai që e ka sjellë pikën ai edhe mund të propozon për ta hequr, kështu që drejtori e ka sjellë drejtori e propozoj ta heq.

Tani meqë një pjesë e anëtarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së po kërkojnë që unë t'ia jap fjalën, ju lutem më gjeni në Rregullore ndokund që thotë se ka të drejtë, unë do t'ia jap fjalën edhe pse askush nuk mund të më tregoj a t'ia jap fjalën apo jo dikujt.

**z.Valon Demolli**, nga vendi i kërkon Kryesuesit të Kuvendit që kjo çështje të mos banalizohet kështu në këtë formë por t'i jepet fjala z.Naim Çunaku të deklarohet rreth këtij propozimi që u bë për ta heq nga rendi i ditës pikë në fjalë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ti zotëri Çunaku mund të qëndrosh në foltore por nuk mund ta marrësh fjalën pa ta dhënë unë. Nuk ka debat për propozime në rend të ditës dhe për t'ju sqaruar tani po e lexoj dispozitën përkatëse të Rregullore së punës së Kuvendit, citoj, *propozimet për plotësimin apo ndryshimin e rendit të ditës në parim bëhen në formë të shkruar dhe i dërgohen Kryesuesit të Kuvendit më së voni deri në fillim të mbledhjes. Kuvendi vendos veç e veç për çdo*

*propozim për ndryshim apo plotësim të rendit të ditës. Së pari sipas radhës së paraqitur shqyrtohet propozimi që çështja e propozuar të hiqet nga rendi i ditës.*

*Propozimet për plotësimin e rendit të ditës bëhen me analogji sipas mënyrës së përcaktuar nga paragrafi paraprak.*

Pastaj kemi nenin 37 pika 1 ku thuhet, *për propozimet për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës nuk hapet debat, por pas arsytimit të shkurtra të propozuesit dhe sqarimeve të Kryesuesit të Kuvendit, përfaqësuesit e Ekzekutivit apo propozuesit e çështjes konkrete, kalohet në votim.*

Pra po e shihni se kështu e përcakton Rregullorja e punës së Kuvendit dhe unë nuk mund ta shkeli tash për këtë çështje si dhe nuk do ta shkeli dhe nuk do veproj në kundërshtim me Rregulloren.

Përndryshe juve ju konvenon sa herë që e shkeli Rregulloren dhe ju vet nuk e keni gajle, kurse çdo herë më qëndroni pararojë mua mos rastësisht po e shkeli, prandaj sot jam duke e mbrojtur dhe lus të shkosh në vend i nderuar sepse fjalën nuk mund ta jap.

**z.Naim Çunaku**, sërish vazhdoi duke insistuar se për deklarimet e Grupeve është obligim të na jepet fjala, ti Kryesues dhe Rregullorja jeni shumë larg ndërsa thotë që nëse dikush është shkelës i Rregulloreve së punës së Kuvendit je ti Kryesues sikurse që je edhe nënçmues ndaj kolegëve tuaj, si dhe nëse dikush nuk është në nivel të detyrës për rolin që ka je ti zotëri Kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, faleminderit zotëri Çunaku për këto fjalë që i potencove, tani mund të shkosh në vend dhe ta lirosh foltoren.

Urdhëroni e hedh në votim propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 17 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi për heqjen nga rendi i ditës dhe shtyrjen për një prej mbledhjeve të radhës pika 2 e rendit të ditës*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, tani po shohim se mikrofonat nuk janë duke funksionuar dhe kjo është puna e Kryesuesit të Kuvendit, mbarëvajtjen e mbledhjes dhe kontrollin, kjo është punë e jotja Kryesues edhe njëherë po ta them, e jo ato që po ndodhin.

A është serioze kjo situatë kështu i nderuar Kryesues që nuk funksionojnë mikrofonat dhe më pamundësohet ta them atë për çka mora fjalën. Ti që po thirresh në Rregullore dhe po i din të gjitha e që je shkelësi më i madh i mbarëvajtjes së Kuvendit, përse nuk jep pauzë, çka është ky cirkus me Kuvendin e Komunës, kush je ti ai që mund të vësh në lojë dhe në këtë gjendje Kuvendin e Komunës. Ti Kryesues tani po më ndërhysh duke më thënë mos shit pallavra, mirëpo unë të them ty se pallavergjia më i madh që mund të jetë këtu, këtu je ti.

Jepe një pauzë deri sa të rregullohen mikrofonat ngase ne nuk mund të rrimë këtu në këmbë për ta marrë fjalën.

**Kryesuesi i Kuvendit** kërkon të shkohet në pauzë për 15 minuta deri sa të rregullohen mikrofonat.

*Nga pothuajse shumica e anëtarëve të Kuvendit që ishin prezent në sallë mbështetet propozimi që të shkohet në pauzë të shkurtër 15 minuta.*

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 11:10

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani çdo gjë është rregull dhe mund të vazhdojmë me punë, urdhëroni kush e kishte fjalën.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, në një formë ndoshta kërkoj falje për atë që ndodhi, jo me fajin tim por me fajin e Kryesuesit të Kuvendit që zakonisht din t'i bëjë këto gjëra e në veçanti aty ku i konvenon dhe ku e ka shtytjen aso fare që nganjëherë din edhe të bëhet burrë, për të keq e kam fjalën, por është hera e parë që ndodh në Kuvendin e Komunës së Podujevës që nuk i'u jepet fjala që në emër të Grupeve të deklarohen rreth pikave të rendit të ditës, andaj ky sihariq i ri edhe ne si grupim tani e tutje në bazë të rrethanave të krijuara duhet të hartojmë strategjinë tonë se si t'i qasemi kësaj keq menaxhimit të seancës. Para se të flas, Kryesuesi me një mund të zanatit të tij...

**Kryesuesi i Kuvendit**, ndërhyrë duke kërkuar nga parafolësi që të vazhdoj me temën sepse nuk jemi këtu për ta na jap ligjërata.

**z.Naim Çunaku**, vazhdoi, edhe tani Kryesuesi i Kuvendit është bërë i padurueshëm dhe nuk e din që në atë Rregullore që pak më parë e citoj nuk shkruan vetëm ajo që e lexoj ai, por është edhe një nen aty 42 pika 1 i cili i jep të drejtë çdo këshilltari të Kuvendit të Komunës që në atë moment që ai e sheh se ka shmangie nga Rregullorja të paraqes vërejtjet e tij që puna e Kuvendit të hyj në vargun e rregullsisë së Kuvendit, dhe Kryesuesi i Kuvendit deshti ta luaj rolin e tij të tigrit prej letre duke e lexuar Rregulloren dhe duke thënë që nuk ka debat për pika të rendit të ditës, ndërsa deri sa citonte aty që jua bëri qejfin edhe disa të tjerëve që po din të citoj, harroi që në citimin e tij para neve e paraqiti që për heqjen e një pike prej rendit të ditës duhet të ketë me shkrim nga propozuesi tërheqjen e pikës nga rendi i ditës, dhe krejt kjo ishte një sihariq i ri për mua që nuk jam mësuar ta shohë në këtë formë.

Kërkesa e grupimeve politike në këtë Kuvend, gjegjësisht e grupit të LDK-së në këtë rast ishte që vetëm të deklarohet, ta orientoj Grupin që ta përkrahë apo mos e përkrah propozimin për heqjen e një pike nga rendi i ditës dhe ato fjalë që deshta t'i them po i përsërisë tani. Unë sikurse të gjithë ne e kemi përpunuar materialin e Planit të Mobilitetit dhe vërtetë deshta t'ia them edhe drejtorit që ajo pikë e rendit të ditës është bërë mirë që u heq, është keq që është vonuar më tepër se dy vite dhe ai Plan si i tillë nuk na paraqet as afate kohore, as kosto ligjore as se ku do të realizohen projektet, andaj u bë mirë që u tërhiq dhe poenta ime ishte që ta thërras Grupin tim që ta mbështes tërheqjen e asaj pike nga rendi i ditës.

Tani zotëri Kryesues për shkeljet që ti i bëre, lexoje publikisht shkeljen që ti e bëre e që këshilltarëve edhe mund t'iu lejohet por prej një Kryesuesi kredibil nuk do të duhej të ndodhte.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron falën rreth rendi të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës së bashku me konstatimet e rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe heqjen e pikës 2 të rendit të ditës ashtu siç u përkrah paraprakisht.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, zotëri shërbyes civil, është e pa tolerueshme ndërhyrja jote në punën e Kuvendit, këtu ti je të numërosh por jo të sugjerosh se a e qet Kryesuesi në votim apo nuk e qet Kryesuesi në votim, a e tërheq apo nuk e tërheq dhe mos e ngatërro punën tuaj sepse nuk je i zgjedhur i popullit por je shërbyes civil.

Pra edhe një shkelje zotëri Kryesues.

*(me këtë reagim i drejtohet zyrtarit të zyrës ligjore i cili gjatë procesit të hedhjes në votim të rendit të ditës i rikujton Kryesuesit të Kuvendit që vetëm të përmend edhe heqjen nga rendi i ditës pikën 2 e cila faktikisht vetëm se mori mbështetjen dhe u votua që të hiqet nga rendi i ditës, pra një gjë të tillë e konsideront si ndërhyrje në punën e Kuvendit).*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe heqjen e pikës 2 të rendit të ditës paraprakisht.*

Rendi i miratuar i ditës:

*1. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2024*

*2. Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevë (vazhdim i diskutimit nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 11.12.2024)*

*3. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë (NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi)*

*4. Të Ndryshme*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani vazhdojmë me punë sipas rendi të miratuar të ditës. Në radhë kemi pikën e rendit të ditës që është raportim i Kryetarit të Komunës të cilit edhe i'a japim fjalën.

## **1. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2024**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, paraqiti raportimin lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2024, theksoi, para se të filloj me raportimin lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2024, po shfrytëzoj nga rasti që dy asambleistëve të ri t'i uroj për detyrën dhe shpresoj që bashkëpunimi jon në këtë periudhë kohore të mbetur do të jetë në nivel.

Më vie keq që kjo seancë e sodit e që besoj se është e fundit për këtë vit, filloj me atë diskutim siç ishte në fillim të mbledhjes por shpresoj shumë që ky muhabet i nisur të përmbillet suksesshëm sepse është seanca e fundit për këtë vit dhe besoj që meqë është fundi i vitit duhet lën anash të gjitha ato çështje ngase gjatë këtij viti besoj se ka qenë bukur me sfida të mëdha por besoj shumë edhe me rezultate të prekshme në interes të qytetarëve tanë si dhe dëshiroj që viti që po hym të jetë vit më i mirë, më me shumë suksese se sa që ky vit që po lëm pas dhe sigurisht që të gjitha ato dëshira dhe suksese të cilat i presin t'iu realizohen të gjithëve.

Lidhur me pikën e rendit të ditës do të bëjë përpjekje që pa ju marrë kohë shumë, të jap në pika të shkurtra disa prej punëve kryesore të cilat janë kryer gjatë vitit 2024 dhe ajo që dua t'ju them është fakti që po lëm prapa një vit me shumë sfida, me shumë telashe por edhe suksese të prekshme.

Po filloj me Drejtorinë e Administratës e cila gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer punët dhe aktivitetet e saja të cilat lidhen me domenin e kësaj Drejtorie duke lëshuar kësi soji certifikata të gjendjes civile në numër prej 74478, prej tyre certifikata të ndryshme për jashtë vendit rreth 30968, certifikata brenda vendit 435190 sosh, pastaj për martesë të reja 455, për vdekje të lajmëruara 310, lindje të lajmëruara në QKMF Podujevë 620, lindje jashtë vendit 620, martesë jashtë vendit 87 si dhe vdekje jashtë vendit 42 sosh. Pastaj përgjithësisht regjistrimet e lindjeve dhe të vdekjeve si dhe ndryshimet e emrit një numër prej 252.

Përveç kësaj kjo Drejtori ka kryer edhe punët që lidhen me infrastrukturën dhe rregullimin e oborrit të Komunës si dhe sigurisht që mendoj se ajo që ka ndodh gjatë këtij viti është ka pas një shërbim të qëndrueshëm me të cilin shërbim besoj se qytetarët tanë janë ndarë të kënaqur.

Drejtorja e Buxhetit dhe Financave, vitin që po lëm pas është planifikuar dhe është bërë aprovimi i buxhetit për vitin 2025 që do të jetë në vlerë 33,459,115.00€ që është buxhet për rreth 2416096.00€ më i lartë se sa buxheti i vitit paraprak. Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës

të realizuara në vitin 2024 janë afërsisht rreth 2.3 milion euro e që kemi një tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake në shumë prej rreth 400,000.00€ e që do të thotë se po përmbillet një vit i suksesshëm edhe në këtë aspekt dhe kjo shumë e jetëve buxhetore sigurisht se do t'i shtohen buxhetit të vitit 2025 me qëllim të realizimit të projekteve që janë të nevojshme për qytetarët tanë. Gjatë vitit 2024 janë regjistruar rreth 1600 objekte dhe që janë sistemuar për tatim në pronë e që do të ndikojnë besoj pozitivisht në rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2025.

Drejtoria e Arsimit ka realizuar një varg të projekteve të rëndësishme në interes të nxënësve dhe të mësimit të tyre. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore, projekti i realizuar me sukses në vlerë financiare mbi 150,000.00€, furnizimi me kompjuter për shkolla në vlerë financiare mbi 171,000.00€, pastaj ndërtimi i rrethojave të shkollave projekt në vlerë mbi 52,000.00€, ndërtimi i objektit të ri shkollor të SHFMU “Ali Hadri” në fshatin Obrancë projekt ky i cili afërsisht ka kushtuar rreth gjysmë milion euro, mandej ndërtimi i objekti të SHFMU “Musli Dumoshi” në fshatin Dumosh projekt ky në vlerë mbi 560,000.00€, ka filluar ndërtimi i objekti të SHFMU “Hasan Ramadani” në fshatin Shajkoc ku kontrata tash më është nënshkruar dhe vlera e saj është afërsisht rreth 600,000.00€ dhe krejt këto bashkë me fillimin e ndërtimit të shkollës së mesme ekonomike në vlerë prej 2,566,649.00€ janë projekte të financuara nga buxheti komunal që do të thotë një shumë relativisht e konsiderueshme e mjeteve buxhetore kanë qenë të orientuara për ndërtimin e këtyre objekteve shkollore dhe kështu po pasurojmë infrastrukturën tonë me objekte të reja shkollore suksesshëm për këtë vit.

Pastaj bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë tash më kemi nënshkruar kontratën dhe presim përmirësimin e kushteve që të filloj realizimi i ndërtimit të shkollës së mesme profesionale të kompetencës në vlerë 2,430,000.00€. Kemi filluar ndërtimin e sallës ose palestrës sportive në SHFMU “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël projekt ky në bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal e që është në fazën e realizimit dhe ka vlerën 373,000.00€. Kemi vazhduar me renovimin dhe adaptimin e Çerdhes në shkollën “Hamit Sejdiu” në fshatin Kërpiemeh projekt ky i cili ka shumën rreth 200,000.00€ dhe projekt i cili tutje do të shfrytëzohet për Çerdhen e re në atë lokalitet.

Po ashtu janë bërë investime të rëndësishme në zgjerimin e kapaciteteve të shkollës “Naim Frashëri” në qytet me ndërtimin e një aneksi me qëllim të që kalohet nga ndërrimi trendrimësh në dyndrimësh. Po ashtu janë edhe një varg projektesh tjera të cilat janë të rëndësishme që janë realizuar në Drejtorinë e Arsimit siç është rasti me ndërtimin e sallës sportive në shkollën “Enver Maloku” projekt i cili është në fazën përfundimtare dhe shpresojmë që shumë shpejt ta kemi në dispozicion, pastaj furnizimi me kabinete për lëndët e gjeografisë, historisë, matematikës projekt në shumë mbi 50,000.00€. Mandej realizimi i dy Çerdheve po vazhdon në fshatin Batllavë dhe në qytetin e Podujevës dhe këto dy projekte financohen nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë si dhe po ashtu po vazhdon ndërtimi i objekti të shkollës në fshatin Llugë projekt i cili është në fazën e tretë që është faza finale dhe po shpresojmë që ndoshta në muajin shtator të vitit të ardhshëm ta kemi në dispozicion për fëmijët e atij fshati.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka kryer një varg të punëve dhe detyrave në domenin e saj, në total kemi diku rreth 192617 vizita që janë realizuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, prej tyre në Emergjencë janë rreth 59808; në kujdesin paliativ si shërbim i ri i cili është pritur jashtëzakonisht mirë prej qytetarëve janë bërë 9568 vizita; pastaj programe të zhvilluara për gratë shtatzëna dhe fëmijë 0 deri në 3 vjeçar janë rreth 1152 vizita; shërbime tjera specialistike si pediatri, epidemiologji janë 465 vizita; stomatologjia 6365 vizita; laboratoritë 26029 teste të ndryshme laboratorike që janë kryer; pastaj rëntgeni diku rreth 18685 vizita; shërbimi i insulinës 657 pacientë të ndryshëm që janë trajtuar; këshillime për diabet 4536; vaksinime të

rregullta 15241 vizita; pastaj vizita sistematike të fëmijëve dhe nxënësve në shkolla rreth 3321 vizita; e kështu me radhë.

Po ashtu përveç punëve shëndetësore profesionale kjo Drejtori ka realizuar edhe një varg projektesh të ndryshme në infrastrukturë siç është ndërtimi i objektit të Urgjencës në vlerë prej 1.7 milion euro projekt i cili ka qenë bashkëfinansim në mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës nga Katari dhe që tani është në dispozicion të qytetarëve tanë dhe që po shfrytëzohet, pastaj furnizim me pajisje mjekësore projekt ky në vlerë 106,000.00€, servisim i pajisjeve mjekësore projekt ky në vlerë mbi 35,000.00€, renovimi i objekteve shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në terren projekt ky i realizuar në vlerë mbi 90,000.00€, renovimi i hapësirës së radiologjisë projekt ky i realizuar në vlerë mbi 90,000.00€, furnizime me barna po i ofrohemi gradualisht shumës rreth gjysmë milion euro subvencionime të qytetarëve me barna, mandej ka vazhduar punën ndërtimi i Qendrës Rezidenciale projekt ky i cili kap vlerën rreth 2.5 milion euro dhe po shpresojmë që vitin e ardhshëm do ta kemi në dispozicion si projekt.

Po ashtu kjo Drejtori ka bërë edhe subvencionimin e një varg të OJQ-ve të ndryshme siç është rasti me Organizatën “Handikos” në vlerë 9,500,00€; OJQ-në tjetër “Autizmi” në vlerë 8,500.00€; OJQ-në “Ofama” në vlerë 2000.00€, por njëkohësisht gjatë kësaj periudhe kohore kemi pas edhe ndihma për familjet në nevojë ku ndihma me pako ushqimore për 350 familje, shujta ditore për 50 persona, strehim social për 34 persona, me shtëpi të ndërtuara nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit” 5 shtëpi dhe projekte të tjera për vitin 2024 janë edhe renovimet e shtëpive për familjet me kushte të rënda sociale, mandej ndihmë për familjet e komunitetit ashkalinjë, ndihmë për renovimin e shtëpive dhe kushteve të jetesës e kështu me radhë.

Po ashtu kjo Drejtori brenda kompetencave të veta ka edhe shërbimet sociale e që në vitin 2024 Qendra për Punë Sociale ka trajtuar raste të dhunës së familje që janë 83 raste, fëmijë me aftësi të kufizuara 36 raste, shpallje të peronave të vdekur 4 raste, vërtetime mbi zotësinë e veprimtimit 589 raste si dhe një varg punësh tjera për të cilat nuk po dëshiroj t’ju ngarkoj më tepër duke përmendur shifra sepse besoj që këto të dhëna do të jenë edhe publike për qytetarët por edhe për juve.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjithashtu ka kryer një varg të punëve dhe projekteve që lidhen me këtë Drejtori. Për Leje mjedisore kanë qenë 30 kërkesa prej tyre në procedurë janë 7, të aprovuara janë 20, të refuzuara janë 2 dhe 1 njoftim, mandej Leje ndërtimore komunale, informata mbi Planin urbanistik 21 kërkesa, për Kushte ndërtimore 67 kërkesa, leje ndërtimore 42 kërkesa, pëlqime në parim 84 kërkesa, pastaj te legalizimet 10 kërkesa të përmbyllura, në listë të pritjes janë 5 kërkesa, njoftime për taksa 3, njoftime për plotësim të dokumentacionit 3 kërkesa, të refuzuara 11 kërkesa e në total janë 32 kërkesa gjatë vitit 2024.

Brenda kësaj Drejtorie janë realizuar edhe një varg projektesh të ndryshme asfaltime të rrugëve të ndryshme, janë përfunduar rreth 13 projekte të ndryshme të asfaltimit të rrugëve me një gjatësi mbi 30 km në total, në proces të punëve janë edhe 7 projekte të tjera. Lista e rrugëve që janë asfaltuar gjatë këtij viti janë në fshatrat Llugë, Gërdoc, Kaçybeg, Dumnicë, Livadicë, Llaushë, Surkish, Sfeçël, Shajkoc, Gllamnik, Konushec, Obrancë dhe shumë e shumë rrugë tjera për të mos ju lodhur shumë duke përmendur të gjitha, mirëpo ato që janë më shumë të rëndësishme janë rruga e cila lidhë qytetin me magjistralen Podujevë-Prishtinë në gjatësi rreth 1.256 km e cila është në fazë të vazhdimit të punimeve sikurse që është edhe rr.”Xhemajl Mustafa” që për mungesë të mjeteve buxhetore nuk arriti të përmbillet komplet si projekt në këtë vit. Kemi edhe disa rrugë që janë projekte dy vjeçare që planifikohen të përmbillen në vitin 2025 që është asfaltimi i disa rrugëve në qytet, asfaltimi i rrugëve Dumosh-Sfeçël, Bradash-Dobratin, Letanc-Llaushë-Dumnicë, pastaj ndërtimi dhe rehabilitim i rrugës Podujevë-Merdar, rikonstruimi dhe rehabilitimi i rrugës



“Dëshmorët Babatinca”, asfaltimi Orllan-Kushevic-Nishefc dhe asfaltimi i rrugës nga gurëthyesi deri te rruga “Sahit Llallosi” në fshatin Herticë.

Po ashtu kjo Drejtori në vazhden e aktiviteteve brendapërbrenda kësaj Drejtorie ka hartuar Planin Rregullues të Zonës Industriale por edhe projekte të ndryshme të infrastrukturës qoftë të rrugëve, kanalizimeve por edhe të objekteve tjera të cilat lidhen me Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në veçanti hartimin e projekteve që lidhen me sera të ndryshme.

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë gjatë këtij viti ka pasë ose ka shqyrtuar dhe trajtuar rreth 1753 kërkesa për regjistrim dhe bartje të pronësisë, prej tyre 1621 janë të aprovuara ose 92.5% prej tyre, 125 kërkesa janë në procedurë ose 7.1%, si dhe 7 prej tyre janë të refuzuara apo 0.4%, pastaj 670 kërkesa kanë qenë për ndarje dhe bashkim por edhe legalizim të njësive të ndryshme kadastrale, 28 kërkesa për historik të pronësisë, 168 kërkesa të hipotekave, mandej 482 kërkesa për korrigjim të të dhënave personale, 6276 kërkesa për certifikata pronësie dhe shërbime tjera si dhe një varg punësh dhe detyrash tjera që janë në këtë Drejtori.

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, te investimet kapitale kemi këto projekte, renovimi i hapësirës së Galerisë së Arteve deh rregullimi i oborrit si dhe objektit të vjetër të Komunës, ndërtimi i Qendrës Multifunkcionale projekt ky i cili po vazhdon së realizuari edhe në vitin 2024 e që besoj se në vitin 2025 do ta kemi në dispozicion, mandej kemi ndërtimin dhe vendosjen e Shtatores së presidentit Ibrahim Rugova, ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive në vlerë prej 425,000.00€, pastaj ka nisë puna për ndërtimin e aneksit të administratës dhe renovimi i hapësirës së Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani”, si dhe tani janë iniciuar procedurat dhe është bërë hapja e tyre për rregullimin e memorialit Afrim Zhitia dhe Shtatoren e tij në fshatin Llugë.

Po ashtu kjo Drejtori ka bërë edhe një vargë subvencionesh për kulturë, rini dhe sport përmes thirrjeve publike ku janë përkrahur rreth 50 organizime të ndryshme kulturore, galeria e Arteve ka ekspozuar 8 ekspozita në vitin 2024, pastaj kanë qenë rreth 10 aktivitete të ndryshme kulturore, Ditët apo më mirë të themi Muaji i Diasporës që ka pas një varg aktivitete që janë realizuar ku janë organizuar 5 koncerte, kinemaja ka organizuar 8 dokumentar, 10 filma në kinemanë e hapur, 3 panairë të librit, 2 produkte artizanale, janë realizuar 4 festivale përfshirë atë “Bëje Shqiponjën” dhe atë “Valët e Llapit”, si dhe një varg takimesh dhe aktivitete që lidhen me këtë Drejtori.

Teatri i Qytetit ka shfaqur 2 premiera dhe 4 repriza, po ashtu trupa jonë teatrore ka qenë pjesëmarrëse në 4 festivale teatrore. Po ashtu Biblioteka është furnizuar afërsisht me rreth 1100 tituj të ri, pastaj studentët janë furnizuar me numër të madh të literaturës profesionale adekuate sipas nevojave të tyre, mandej kemi pasë 5 aktivitete të ndryshme rinore.

Te sporti po ashtu ka pas një varg ngjarjesh të ndryshme sportive me rreth 40 sosh në fusha të ndryshme të sportit.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjesh Shpëtimit, në këtë Drejtori janë realizuar rreth 2.765 km të ndërtimit të trotuareve, zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap në qytet ku janë rregulluar rreth 800 m brigje të lumit, hartimi i projektit për rregullimin e lumenjve i cili është në procedurë të zhvillimit, pastaj riparimi i rrugëve të asfaltuara me rreth 553 m<sup>3</sup> asfaltim, mandej kemi ndriçimin publik me rreth 2766 metra ndriçim publik, rregullimi i infrastrukturës për varreza procedurë kjo e cila ka ngecur gjatë këtij viti për arsye të çështjeve pronësore, pastaj është bërë ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Lluzhan-Lupç, Gërdoc-Lluzhan, kolektori në Lotet 1 dhe 3 që janë duke u punuar, mandej është bërë rregullimi i rrugëve me zhavorr në fshatrat Sylevicë, Llapashticë, Metergoc, Brainë-Metergoc, Batllavë, Majac, Herticë, Godishnjak e kështu me radhë. Kemi bërë edhe ndërtimin e mureve mbrojtëse rreth 210 metra së bashku me kanalet kulluese, pastaj ndërtimin e 4 urave që janë në fshtrat Majac, Lluga, Pollat si dhe një në qytet afër lagjes së Bebushëve. Pastaj janë bërë ndërtime të rrugëve me kubëza, mirëmbajtja verore dhe dimërore,

mirëmbajtja e infrastrukturës publike, mirëmbajtja e lumenjve, furnizimi me drunj dekorativ, është bërë edhe trajtimi i qenve endacak, mirëmbajtja e ndriçimit publik si dhe një varg projektesh tjera që lidhen në fushën e kësaj Drejtorie.

Drejtoria e Inspeksionit ka kryer një varg inspektimesh të ndryshme, prej tyre Njësia e tregut komunal ka bërë 389 inspektime, ka pasë 60 ankesa/kërkesa prej tyre 30 ankesa të zgjidhura, 25 largime të objekteve të përkohshme kioska, largim i 10 pengesave, gjoba mandatorë 14, kontrolle të përbashkëta 1556, akisone me policinë 5 e kështu me radhë.

Njësia për mbrojtjen e mjedisit brenda kësaj Drejtorie ka bërë 169 procesverbale, 245 kontrolle inspektuese të përbashkëta, 27 gjoba mandatore, kërkesa/ankesa 14, raporte 62, kërkesa për përmbarrim 3, kërkesa për procedurë kundërvajtëse 1 e kështu me radhë.

Njësia e komunikacionit ka bërë 3 procesverbale, 17 ankesa, 2 gjoba mandatorë, inspektime të përbashkëta 210, inspektime me policinë 25, raporte mujor 11.

Po ashtu edhe Njësitë tjera brenda kësaj Drejtorie kanë kryer punë dhe aktivitete të ndryshme mirëpo nuk do t'ju ngarkoj shumë me këto shifra.

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2024 ka realizuar një varg projektesh të ndryshme që lidhen me subvencionimin në fushën e primëkulturës në vlerë prej 357,000.00€ ku kanë përfituar 85 fermerë me sera 500m<sup>2</sup> dhe 85 fermerë janë përkrahur me sera 50m<sup>2</sup>. Po ashtu kemi pasur subvencionime në sektorin e blegtorisë në vlerë 385,000.00€ ku përfitues janë 354 fermerë që janë përkrahur me mëshqerra, pastaj subvencionim me mekanizëm bujqësorë 144,857.00€ ku janë përkrahur 103 fermerë me mekanizma të ndryshëm bujqësorë, mandej kemi subvencionime në pemëtari në vlerë mbi 70,000.00€ ku prej tyre 10 fermerë janë përkrahur me fidanë fërfërinë, 4 fermerë me fidanë të dredhës dhe 4 fermerë me fidanë të mjedrës, subvencionime në bletari në vlerë mbi 40,000.00€ prej tyre 17 fermerë janë përkrahur me dublifikator elektrik dhe 16 fermerë me koshere.

Për herë të parë kemi lansuar platformën e tregut online për produkte të ndryshme bujqësore, si dhe po ashtu kjo Drejtori ka kryer edhe një varg të punëve dhe aktiviteteve tjera që lidhen në fushën e kësaj Drejtorie.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - puna për projektin e rregullimit të hapësirave në fshatin Dumnicë e Poshtme, Kërpimeh, Bajçinë, Llapashticë, Sfeçël në vlerë prej 100,000.00€ kontrata është në ankesa andaj edhe nuk ka mund të ec tutje si projekt.

Broshura informuese, projekti i promovimit të potencialit turistik dhe ekonomik të Komunës së Podujevës është në përfundim, mandej kemi Zonën Industriale për të cilën është bërë Marrëveshja me Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ku janë kryer të gjitha procedurat dhe informacionet që i kam tenderin që e ka shpall kjo Ministri ka shkuar në Organin Shqyrtues i Prokurimit dhe informacionet janë që është tejkualuar ajo ankesë dhe është kthyer në favor të iniciuesit të kontratës dhe po presim që këto ditë ndoshta të lidhet kontrata me operatorin punëkryes përfitues për fillimin e punimeve në Zonën Industriale.

Tregu i gjelbër tash më jemi në dijeni se ka filluar si projekt në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rural në vlerë prej 1,440,000.00€ projekt i cili është në vazhdim të punimeve, si dhe janë kryer të gjitha procedurat sa i paket parkingut nëntokësor projekt ky me Partneritet Publiko Privat dhe presim për pak ditë se cili do të jetë rezultati final i këtij projekti.

Është bërë mbështetje për rreth 90 biznese lokale projekt ky duke përfshirë edhe start-up e ndryshme por dhe bizneset ekzistuese, projekt në vlerë prej 142,000.00€, pastaj mbështetje për fermerë ku janë 49 përfitues me sera 100m<sup>2</sup> projekt ky në bashkëpunim me organizatën "Islamic Relief Kosova" në vlerë 58,000.00€. Është subvencionuar Ndërmarrja e re Publike Lokale "Eko-Llapi" për tu furnizuar me mjete pune në vlerë mbi 247,000.00€, po ashtu kësaj Ndërmarrje i është

bërë edhe një mbështetje tjetër, mandej është subvencionuar edhe Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” meqë ka kaluar në objektin e ri.

Po ashtu ka pas projekte të bashkëpunimit që lidhen me festivalin Ditët e Diasporës por edhe Ditët e festave të fund vitit si dhe në kuadër të kësaj drejtorie është në procedurë edhe Strategjia e Turizmit 2025 - 2028 e Komunës së Podujevës.

Këto ishin disa prej punëve dhe projekteve më të rëndësishme të cilat kemi pasë mundësinë t’i realizojmë në vitin 2024. Disa prej tyre si punë dhe projekte vazhdojnë në vitin 2025 dhe ajo që mund të themi është fakti që nuk e kemi përmend shumë herë por që ka qenë një vit bukur sfidues sa i përket shpenzimit të buxhetit për arsye se ju e dini që për shkak të Kontratës Kolektive brenda këtij viti kemi paguar përmes Përmbartuesve Privat diku një shumë financiare rreth 5 milion euro buxhet dhe fatkeqësisht disa prej projekteve në periudhën e fundit të vitit na janë cenuar seriozisht si rezultat i realizimit të këtyre obligimeve financiare të cilat kanë dalë nga një Kontratë e “famshme” e nënshkruar shumë vite më parë por që në këto kohë faktikisht ka filluar të zbatohet praktikisht në terren, por ajo që mund ta themi është fakti që falë një bashkëpunimi të mirë me nivelin qendrorë Komuna e Podujevës ka përfutur projekt në vlerë prej 15 milion euro përmes formës së memorandumeve të ndryshme të cilët janë nënshkruar me resorë të ndryshëm ministrore dhe këto vërtetë na kanë lehtësuar shumë punën tonë si institucione lokale por njëkohësisht këto mjete kanë ndikuar pozitivisht edhe në realizimin e një numri të madh të projekteve të cilat tash më janë duke i prekur të gjithë qytetarët tanë. Kjo sigurisht që është bërë falë një angazhimi të përgjithshëm edhe të ekipës me të cilën kam punuar si Ekzekutiv por edhe bashkëpunimit të mirë që kemi pas me asamblenë komunale për arsye se vërtetë i keni shtyrë punët dhe që keni vlerësuar që janë në interes të përgjithshëm, andaj për të gjitha këto un[ meqë është seanca e fundit e këtij viti po dëshiroj t’ju shpreh falënderim të gjithëve për bashkëpunimin korrekt dhe të sinqertë dhe besoj se me këtë formë të bashkëpunimit do të vazhdojmë edhe në vitin 2025 vit ky i cili për Komunën tonë është me një numër të madh të projekteve të ndryshme, është vit zgjedhor dhe unë besoj se bashkërisht në këtë formë çfarë kemi punuar deri tani do të vazhdojmë bashkëpunimet e përbashkët duke i shtyrë projektet përpara që janë me interes për qytetarët.

Ju falënderoj për vëmendje.

**z.Haki Rudari**, theksoi, fillimisht në emër të Grupit të LVV kolegëve të rinj këshilltar dhe këshilltare të Kuvendit për mandatin për këta muaj që kanë mbete në vazhdim e që po besoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë dhe një debat të mirë ose të frytshëm.

Ne dëgjuam informatën e Kryetarit të komunës për vitin 2024 ku realisht pati informime për investime apo projekte të shumta nëpër drejtori të ndryshme ku për secilën Drejtori u paraqiten investime të ndryshme e që unë në emër të Grupit të LVV-së e përkrahë por në të njëjtën kohë kërkoj që të ketë një angazhim, një përkushtim dhe një seriozitet më të madh edhe në vitin 2025.

**z.Valon Demolli**, theksoi, Kryetari i Komunës në javën e kaluar pati një takim me qytetarë dhe ajo që ra në sy ishte fakti se ai takim nuk u mbajt në orarin e caktuar dhe me arsyen e mungesës së kuorumit u desht të shtyhet ora e takimit për t’i detyruar disa drejtor të shkollave dhe disa mësimdhënës për të qenë prezent në atë takim. Në atë takim nga ky Ekzekutiv i LVV-së u bë kinse prezantimi i projekteve dhe sukseseve të kësaj qeverisje, por të mos harrojmë se është po ky Ekzekutiv më i dështuari ndonjëherë që ka pasë Komuna e Podujevës.

Nga Kryetari i Komunës u bë prezantimi për secilën Drejtori kinse për sukseset e tij, por kjo qeverisje është ajo e cila ka degraduar e shkatërruar gjithçka. Kryetari i Komunës përmendi statistikën e punës së administratës por nuk përmendi keqpërdorimet për servisim, sigurim dhe regjistrim të automjeteve të Komunës, madje edhe autoambulancat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të pasiguruara dhe pa regjistruara.

U përmenden disa projekte si me rëndësi siç ishte Urgjenca e Qytetit, Stacioni i Autobusëve, rrugët, trotualet, Qendra Multifunkionale, ndërtime, Harta Zonale, shkolla, çerdhe, Qendra rezidenciale e të tjera e që të gjitha këto u paraqiten si suksese të kësaj qeverisje, por të mos harrojmë se kjo qeverisje e la Llapin pa Spital duke premtuar Poliklinikë e as atë nuk e realizoj.

Janë këta që projektin e Urgjencës dhuratë nga Organizata e Katarit e proklamojnë si sukses dhe e prezantojnë si Spital të Qytetit. Shpallin konkurs e pranojnë mjek dhe infermierë për Qendrën Rezidenciale e cila ende nuk është funksionale.

E kemi Drejtorinë e Arsimit që e paraqitni si sektorin më me rëndësi dhe më të zhvilluar, por që e keni degraduar, keni punësuar familjarë, miq, reja e bija. Drejtori i kësaj Drejtorie i'a lehtësoj punën shefit të tij lidhur me punësimet në sektorin e arsimit duke bërë punësime në kundërshtim me ligjin për zyrtarët publik, i cili pra qëllimisht anashkaloi sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore ku sipas raportit të auditorit bëri 141 punësime jo legjitime në vitin 2021 e që po ashtu njëjtë vazhdoi edhe në vitet 2022 dhe 2023 dhe po ashtu po vazhdon njëjtë edhe në vitin 2024.

Për mënyrë tjera duke përzgjedh mësimit nga lista e pritjes (Lista e famshme), duke bërë përgjysmimin e orëve mësimore, pra duke i'u marrë orët mësimdhënësve dhe për t'ju ndarë ato dikujt tjetër, mirëpo më e keqja është se mësimitdhënësve i'u bëhet kontratë pa u zhvilluar procedurat e konkursit në sektorin publik. Për fatin e keq nga kjo Drejtori që nga marrja e mandatit asnjëherë nuk kemi pasë në informatë të mirëfilltë sa ishte numri i drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, ushtruesve të detyrës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, nxënësve dhe mësimitdhënësve, nxënësve me nevoja të veçanta, fushata dhe aktivitete tjera vetëdijesuese kundër dukurive negative nëpër shkolla. Madje për ta shpërblyer "baxhën" i keni lënë pa nxënësit dhe shkollat e Komunës së Podujevës.

Sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit atë e kemi në një nivel ku nuk ka asnjë raport dhe sa është numri i ndërtimeve pa leje, sa është numri i objekteve të rrënuara dhe përse shtëpia e Kryetarit të Komunës nuk është rrënuar e cila është në pronë komunale, kurse nuk tregoni përse drejtori i kësaj Drejtorie shkon e vë shirita e pastaj vet ai i heq ata shirita, përse nuk ka inspektor të ndërtimit dhe kujt i shërben mungesa e tij, Kryetarit apo ish drejtorit të Urbanizmit.

Sa i përket Urbanizmit, aty është "qershia mbi tortë", nuk dihet numri i lejeve të ndërtimit, nuk dihet se kush dhe ku ndërton dhe a ndërton në bazë të Hartës Zonale, dhe kush e ka kaluar koeficientin e ndërtimit dhe përse Drejtorja e Inspeksionit nuk merre masa kjo nuk ka ndonjë shpjegim nga shefi sepse vet shefi i'u thotë le të vazhdohet kështu.

Stacioni i Autobusëve projekt i dështuar me shpenzime milionshe në kurriz të qytetarëve dhe ajo që është më qesharakja vendparkimi i autobusëve për udhëtarë bëhet tek shkolla ekonomike.

Kemi parë se në secilin projekt keni dështuar duke filluar nga procedurat tenderuese, ku në secilin tender keni shkel ligjin e prokurimit duke shpërblyer operatorët ekonomik me çmimet më të larta, pastaj kemi parë se asnjë nga kontrata nuk janë mbikëqyrë sipas rregullave dhe rrjedhimisht janë kryer punime shkel e shko.

Në Kadastër kemi dështim total, nuk ka dhënie të pronave në shfrytëzim, nuk ka publikim të listave të pronave të uzurpuara, arsyeja dihet sepse Kryetari i Komunës është uzurpator.

Në Zhvillimin Ekonomik kemi ngecje dhe po e ceku vetëm Zonën Industriale e cila është në kundërshtim me Hartën Zonale, pra votohet për hektar të caktuar dhe përgjysmohet.

Prokurimi publik siç e dim është në vijë me Zyrën e Kryetarit.

Në Shëndetësi kemi parë një qasje shumë jo serioze dhe ofenduese, kanë qenë pamjet që i kemi parë në Ambulancat e Mjekësisë Familjare në Komunën tonë, kjo është qeverisja që mund ta ofroni, e keni përkthyer Spitalin në Poliklinikë e që ajo Poliklinikë a mbete vetëm në letër, kaq

qasje serioze keni ju ndaj Shëndetësisë në Llap e që nuk është për tu habitur sepse siç e dim në krye të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë e kemi një “ciceron”.

Sa i përket sportit, subvencionet në sport ku janë shpërblyer familjarë dhe miq si shokët e juaj duke anashkaluar sportistët më meritë. Më thuani cila fushë sportive është e përfunduar edhe pse kontrata përkatëse pothuajse është në përfundim dhe asnjë fushë e vetme nuk është përfunduar në Komunën tonë. Sa i përket Bujqësisë janë anashkaluar bujqit dhe fermerët e vyer kurse janë shpërblyer njerëz të afërt të pushtetit dhe nuk janë kompensuar dëmet, por pasi e keni shpërblyer “101-shin” besoj që mjafton.

Sot ndjejë përgjegjësi të ngreh zërin në emër të qytetarëve që janë lodhur nga mos mbajtja e premtimeve dhe keq menaxhimi që po ndodh në Komunën tonë, jo vetëm që nuk janë përmbushur premtimet për zhvillimin e Komunës dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve por keni dëmtuar rëndë besimin e tyre në institucionet publike. Korrupsioni, nepotizmi dhe punësimet familjare janë bërë shprehje duke anashkaluar të rinjtë dhe profesionistët e kualifikuar.

Vendimet nuk po merren në bazë të meritës por sipas interesave personale dhe familjare duke lënë jashtë ata që vërtetë duan të kontribuojnë për zhvillimin e Komunës tonë.

Për më tepër sikurse në këtë vit ashtu edhe viteve të tjera të qeverisjes tuaj presioni mbi punëtorët e institucioneve publike për t’iu bindur urdhrave dhe dëshirave tuaja personale, për ne vazhdon të jetë i papranueshëm. Këto institucione dhe punëtorët e zellshëm të tyre duhet të jenë dhe t’iu shërbejnë qytetarëve e jo ashtu siç ju kthehen në vegla tuaja për përfitime politike apo personale. Kërkesat dhe shantazhet për pjesëmarrje në tubime elektorale së fundmi e dëshmon këtë qartë. Kjo qasje e juaja do të shkatërroj çdo mundësi për drejtësi dhe progres në Komunën tonë. Qeverisja juaj jo vetëm që ka stagnuar progresin tek ne por e ka kthyer pas vite e vite mbrapa atë dhe ju do mbaheni mend si re e zezë që rastësisht e fatkeqësisht i ka ndodh Komunës tonë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, dëshiroj të përmend disa pika të cilat u përmenden këtu si sukses por faktet dhe në sytë e mi këto... dhe po filloj prej të fundit që është furnizim me pelet dhe dru nëpër shkolla, gjatë vitit 2024 në muajin gusht ka dal tenderi për dru dhe pelet i cili është vonuar e stërvonuar, afatet kohore kanë qenë 1 muaj për t’i furnizuar dhe nuk janë furnizuar. Në atë kohë me çmimin që kanë konkurruar operatorët ekonomik peleti 1 ton ka kushtuar 179 €, sasia e porositur ka qenë 550 ton dhe shuma 98,450.00€, ndërsa tani me tender të negociimit më 18 dhjetor të këtij viti pasi që bëhen disa malverzime ku KEK fali qymyr pastaj del tender për transportin e qymyrit, jepet tenderi sekret me 269 € për 1 ton pelet.

Shkolla ekonomike që u përmend këtu, nuk e di pse nuk ju erdhi marre ta përmendni sepse unë e kam përcjellë nga fillimi ku ka dal ai tender, kanë konkurruar 9 kompani dhe kompania më lirë ka qenë me çmim 1,947,744.00€ dhe atë brenda suazave sepse edhe në këtë Kuvend është votuar dhe janë ndarë 2 milion euro për atë shkollë, mirëpo tenderi i është dhënë kompanisë së 7 me radhë me një shumë prej 2,565,696.00€ që i bie 617,952.00€ më shtrenjtë.

Kemi edhe çështjen e cila nuk u përmend këtu, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, kontratë në të cilën në vitin 2024 i jepet kompanisë me çmimin më të lirë, pra komisioni i komunës e jep me 330,000.00€, pastaj bëhen ankesa, ndërrohet komisioni, lënda shkon në OSHP, kthehet, ndërrohet pastaj komisioni, shkon sërish në OSHP, kthehet nga OSHP dhe në fund tenderi jepet Kompanisë EING me 567,492.00€ që i bie se na janë vjedhur neve 234,000.00€.

Projekti tjetër që u përmend këtu është ndërtimi i sallës së brendshme sportive në shkollën “Ali Ajeti”, pra bëhet fjalë për një sallë, jo për palestër sportive dhe kjo i jepet kompanisë më të shtrenjtë për 80,800.00€ por që për çudi kompania që ka për ta ndërtuar shkollën ekonomike refuzohet me çmimin më të lirë duke u arsytuar se nuk është e përgjegjshme për ta ndërtuar një sallë sportive e cila ka 4 mure dhe mund ta krahasoni një sallën sportive me shkollën ekonomike.

Mandej kemi shkollën profesionale në Zonën Industriale, edhe këtu kompania më e lirë me 2,130,000.00€ refuzohet dhe i jepet kompanisë së dytë me shumë 2,430,303.00€ që do të thotë mbi 300,000.00€ janë “avulluar”.

Projekti tjetër është ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc ku kompania më e lirë konkurren me një shumë prej 562,633.00€ (4 kompani kanë konkuruar) kurse tenderi i jepet kompanisë së tretë me shumën 594,444.00€ që do të thotë për 31,810.00€ më shtrenjtë dhe plus pas krejt kësaj i jepen për punë shtesë edhe 20,000.00€ dhe aty në dosje të tenderit shkruan, Puna shtesë, dhe shihni sa hajgare është kjo punë, gërmimi i dheut në thellësi 1 metër dhe rrafshimi i terrenit ku do të ndërtohet shkolla, do të thotë përfundon shkolla në fshatin Dumosh pastaj i jepen mjete për ta rrafshuar vendin ku do të ndërtohet shkolla (ose është shkollë sikur e “nastradinit” me rrota që e kanë ndërtuar diku tjetër dhe tani e lëvizin) ose nuk di çfarë t’ju them për këtë punë kështu.

Te subvencionimi i OJQ-ve që u përmend, unë fushatë zgjedhore nuk po bëjë dhe as nuk jam në garë, shembull për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së 1500€, pastaj për OJQ “kthesa” që nuk është nga këtu hiq por është e Prishtinës jepen 8000€, kurse OJQ-së për Mjedis dhe turizëm të qëndrueshëm i jepen 15,000.00€, këtij ‘jaranit’ të Pejës, do të thotë Shoqatave të Luftës 1500€ kurse atij 15,000.00€.

Kemi edhe tenderin e fundit që është dekorimi i sheshit, këtu shembull në foto (prezanton foto) shihet ku janë shpuar pllakat e sheshit e që nuk është lejuar kjo gjë sepse prishen ato pllaka, e kanë vë si të kryer, mirëpo në këtë i kam nënvizuar dy pika; figura dekoruese ndriçuese 172 cop, por që asnjë figurë nuk ka dal në shesh, pastaj tjetra thuhet; vendosja e numrave 2025 në dy hapësira hyrëse të sheshit, e që i bie ashtu siç kanë qenë gjithë ashtu siç e dim ne që kanë qenë te objekti i Komunës së vjetër dhe te kafiteria “Pranvera”, do të thotë është vendosur vetëm njëra kurs tjetra nuk është vendosë fare.

Te administrata, për të mos i hyrë me rend, Komuna e ka reklamuar më 29 maj 2024 duke lavdëruar se si janë rregulluar hapësirat e brendshme kurs pas tre muajve që ka përfunduar puna e cila ka kushtuar mbi 49,000.00€ e thirrën atë ‘jaranin’ dhe i’a japin edhe 5000€ punë shtesë.

E kam edhe një çështje e cila ndoshta paksa është jashtë rendit të ditës por më duhet të përmend sepse ka ndodh një gjë në Komunë shumë interesante, ndërrohen emrat ose emërtimet e rrugëve, as nuk tregohet kush po i ndërron, po të hysh në Gjeoportali emrat e rrugëve janë ndërruar krejt, në Kuvendin e Komunës nuk është sjellë asnjë vendim e që për këtë çështje mua më kanë telefonuar plotë qytetarë duke u ankuar se kush po i ndërron dhe duke më pyetur se a ka qenë kjo çështje në ndonjë mbledhje të Kuvendit apo qysh po ndodh, pra në Kuvend nuk ka pas asgjë, por ajo që mu duk paksa më interesant ishte se unë duke i shikuar rrugët e të tjerëve përmes Gjeoportalit mbërrina te shtëpia ime dhe, madje madje kur e pash që Lumit Dumnica që atë emër e mban qysh shumë moti, i’a kishin ndërruar duke i vë Lumi Lluga dhe kur e pash u çudita dhe u befasova, kush i ka ndërruar dhe kush po i ndërron këto nuk e di, përndryshe unë i kam edhe fotot që i kam nxjerrë nga Gjeoportali dhe mund t’i shohim, por dikush duhet të jap një sqarim për këtë se qysh janë ndërruar këta emra të rrugëve.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, sot jemi duke diskutuar raportimin e Kryetarit të Komunës që e bëri para këtij Kuvendi e mua më vie keq kur nesër hyjmë në çerekun e dytë të shekullit XXI, kurse ne ende flasim këtu e mburremi që një Komunë po shtron asfalt e po shtron zhavorr, QKMF po kryen kaq shërbime e AMF po kryen aq shërbime, fundja Komuna e ka një buxhet dhe ato para diku ka për t’i dërguar si dhe ato punë janë për tu kryer në Komunë andaj nuk është asnjë rezultat dhe asnjë mburrje që mund ta bëjmë me këto projekte që kushdo që vie këtu ato ka për t’i bërë sepse atë buxhet të qytetarëve diku ka për ta shpenzuar, mirëpo nuk kemi dhe as nuk u numërua asnjë projekt vizionar, asnjë projekt afatgjatë dhe asnjë projekt inovativ që e qon mendësinë e të

investuarit dhe zhvillimit përtej kësaj që jemi mësuar përditë e sa vite ta bëjmë, por shtrohet pikëpyetja a ka kush e bënë atë.

Raporti i auditimit për të dytin vit radhazi është i kualifikuar, sërish nuk ndërmerret asgjë dhe jo që merren dhe përmirësohen rekomandimet, por vetëm shkon duke u rritur numri i rekomandimeve nga raporti i auditorit.

Po ashtu raporti i performancës së Komunës së Podujevës, diçka që nuk na është prezantuar e që do të bëja pyetje përse nuk është prezantuar në mënyrë që ta dimë si ka performuar Komuna jonë në vazhden dhe në raport me komunat tjera të Kosovës.

Këto projektet kryesisht çka u përmendën ishin vetëm projekte bashkëfinancimi me Organizata bamirëse e që do t'i rekomandoja Kryetarit të Komunës që ndoshta më mirë do të ishte ta merrte një menaxher nga ato Organizata dhe ta udhëheqë projektet e Komunës për arsye se Komuna nuk po realizon asnjë projekt nga fillimi në fund siç duhet, me të hyra dhe me buxhetin e saj vetanak.

Edhe në këtë vit vazhdon rrotacioni i drejtorëve të Drejtorive ashtu siç jemi mësuar tani më dhe nuk e di a e kanë bërë ashtu me rrotacion apo qysh, por nuk kalon vit që nuk kemi ndërrim të drejtorëve nëpër Drejtori të caktuara, e që edhe kjo mund të quhet një e arritur e Komunës sepse po bënë një përfaqësim m të madh të njerëzve duke i emëruar si drejtor.

Për të mos e zgjatë më shumë sepse shumica e gjërave u cekën nga parafolësit, për fund e kam edhe një çështje që ka të bëjë me mos marrjen parasysh të kërkesave tona dhe në këtë aspekt unë nuk po e ndjej të bollshme ta përsëriti edhe njëherë për kërkesat që marrë nga qytetarët e që lidhen me lokalitetin prej nga vije unë që janë mbeturinat në afërsi të shkollës së fshatit kërkesë kjo të cilën për të satën herë që e përsëris e që Kryetari i Komunës në fillim pati thënë se është mirë të merret një kamerë dhe të incizohen dhe të identifikohen se kush po i hedh ato mbeturina e që sipas meje më bie ta marrë unë rolin e policit dhe të incizoj se kush po hedh mbeturina aty, ndërsa nuk shkojnë dhe t kryejnë punën për çka janë të thirrur për t'i larguar ato mbeturina në atë vend për arsye se po shkaktojnë edhe kundërmim edhe grumbullim të qenve endacak e që siç e ceka është në afërsi të shkollës dhe kemi rrezikim të nxënësve.

Po ashtu edhe tek një urë në të cilën janë rrënuar mburojat e saj në njërën anë, kanë kaluar tash e dy vite që aty rreth dy metra mburoja të hekurit që nuk merret askush për t'i vendosur kurse në atë rrugë për çdo dit frekuentojnë fëmijë por edhe vetura e që është mjaft rrezik. Si dhe ndriçimi publik në fshatin Sfeçël tash është vitit i dytë që me buxhet nuk parashihet asnjë metër ndriçim publik për fshatin Sfeçël.

Gjendje e tillë besoj se është edhe në fshatrat tjera, andaj kjo është performanca dhe raporti i punës që ka bërë kjo qeverisje dhe ky Kryetar i Komunës për vitin që po lëm pas.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, e kuptoj faktin që ne jemi në një fushatë parazgjedhore e që pas vitit të ri edhe do të hyjmë në proces zgjedhor edhe është e kuptueshme që secili subjekt politik këtu tenton që në procese të fushatave parazgjedhore ta përdor për qëllime elektorale që është e kuptueshme dhe është legjitime si dhe demokratike kjo gjë, por njëkohësisht edhe e kandidatëve për Deputet të cilët po mundohen të paraqesin si dështime të palës së kundërt e që mendoj se është normale për t'i treguar elektoratit apo prezantimin para tyre.

Zotëri Kryetar, e dëgjova me vëmendje prezantimin tuaj mirëpo ajo që do të sugjeroja unë është që e kuptoj se jeni i lodhur me angazhime të shumta gjatë këtij viti, mirëpo do të sugjeroja të flasësh me zë të lartë në mënyrë që të na hyjnë në vesh dhe të na hapen veshët për projektet e kryera.

Elementi tjetër është përgjegjësi dhe kompetencë e Komunës së qytetarëve të saj t'i ofroj kushtet elementare të jetesës dhe këtu nënkuptojmë infrastrukturën, shërbimet, lehtësimin e burokracive administrative e që janë elementet kryesore që do të thotë që ka përgjegjësi dhe për detyrë Komuna. Pra Komuna ka përgjegjësi që të investoj në shkolla, në infrastrukturë, kanalizime,

ujësjiellës dhe elemente tjera që e bëjnë qytetin më të zhvillueshëm dhe që është shumë normale që Komuna të fokusohet në këto çështje.

Për fund më lejoni të them se këto fjalimet që i dëgjova unë po i krahasoj me atë kaubojin amater i cili e hedh litarin tërë ditën në kunj edhe asnjëherë nuk i'a qëllon.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, fillimisht deshta t'i them kolegut parafolës që shiko më shpesh me kë e bëjë sepse edhe e hedh litarin. Çështja tjetër është se unë prej që jam asambleiste foli për fëmijët me nevoja të veçanta dhe nëse kolegu parafolës mendon se po i përdorim ata fëmijë, nuk është e vërtetë, mirëpo nuk është bërë asgjë për ata fëmijë, përndryshe unë as nuk jam kandidate për deputete e as nuk e kam që t'i lavdëroj dostat në këtë rast, mirëpo kur është gabim gjithëherë do ta them se është gabim, kush do qoftë.

Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit deshta t'i them që fëmijët me nevoja të veçanta për disa javë me radhë nuk janë duke shkuar në shkollë, nuk e kanë transportin. Unë dëgjova shumë shifra financiare këtu për shkolla, çerdhe, kompjuter, por do të ishte shumë gjë e mirë dhe modeste nëse do të ndahej një shumë e mjeteve buxhetore modeste për ata fëmijë ngase kështu siç është jemi duke jua rëndu edhe prindërve të tyre qoftë në punësim sepse ata prindër duhet që ta lën punën e tyre për dy orë që t'i dërgojnë dhe ti marrin nga shkolla ata fëmijë. Drejtori në fjalë besoj e din shumë mirëpo që është shumë e rëndësishme për ata fëmijë nëse humbet qoftë edhe në ditë e shkollës e lëre më 6 javë.

Do të propozoja që në vitin e ardhshëm të mos ndërrohen vetëm numrat por të ndërrohen edhe mënyrat e punësimeve ngase me qëllimin më të mirë dhe krejt njerëzor ne nuk do të jetojmë vetëm sot ose nesër por do të jetojmë gjatë andaj nuk duhet të thuhet se kjo punë është bërë shumë mirë, përndryshe unë jam shumë krenare për punët e mira që bëhen, mirëpo ju lus që të shkohet fillimisht nga gjërat elementare e pastaj të shkohet me zhavorre e gjëra tjera që po i përmend kolegu parafolës të cilit i them se pastaj do shkojmë bashkë dhe do ta shikojmë atë kaubojin.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, meqë raporti i performancës u përmend pak më parë deshta ta pyes Kryetarin e Komunës përse nuk e ke përfshirë raportin e performancës në këtë raportim tuajin për vitin 2024 dhe përse nuk është publikuar në ueb-faqen e Komunës.

Për këtë shtroj edhe pyetje si ka dal Komuna e Podujevës në raport të performancës, a ka fituar Komuna e Podujevës grant në këtë raport i cili mendoj është kallëzuesi më i mirë se qysh ka performuar Komuna jonë, e jo se qysh ka lëshuar certifikata.

**z.Fatmir Gashi**, theksoi, me vëmendje dëgjova raportimin e Kryetarit për vitin 2024 dhe deshta të bëjë një pyetje se a ekziston edhe më tutje shërbimi i zjarrfikësve apo e ka shuar aktivitetin ngase për habi nuk dëgjova asnjë fjalë për atë shërbim, prandaj pyes a është e mundur të kaloj kështu.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, u pamend rruga Dumnicë-Letanc si një arritje e kësaj qeverisje, mirëpo unë nuk e di me çka jeni duke u krenuar dhe a jeni duke e ditë që rruga e Dumnicës është lloj, është shumë më keq se që ka qenë, kurse ju po krenoheni në raportim, do të thotë është hajgare nga Kryetari që të krenohet me këtë rrugë sepse rruga Podujevë-Dumnicë e përsëris është lloj. Çështja tjetër është se drejtori i Drejtorisë së Arsimit disa herë në këtë Kuvend ka premtuar ndërtimin e fushës sportive në shkollën "Lasgush Poradeci" në fshatin Dumnicë, pra qe 3 vite radhazi e ka premtuar këtë por asnjëherë nuk është bërë, prandaj pyes a duhet të ketë koordinim diqysh në këtë raport sepse nuk e pash e që normale se nuk mund të hyjë.

A ka mundësi i nderuar Kryetar i Komunës, sepse drejtori i DKA-së vetëm po fol dhe asgjë, prej teje po kërkoj që fushën e sportit në shkollën "Lasgush Poradeci" në fshatin Dumnicë ta ndërtoni për shkak se kushtet atje janë të tmerrshme dhe nuk plotësohen nevojat për mbajtjen e mësimit.



**z.Naim Çunaku**, theksoi, ende pa e marrë vetën nga ajo që na ndodhi në fillim të mbledhjes me Kryesuesin e Kuvendit sërish Kryesuesi po bënë të njëjtën gjë sepse kolegja parafolëse e kërkon fjalën për të dytën herë, atë Rregullore që ma citoje mua mësoje pak më shumë sepse ka të drejtë ta marrë fjalën për të dytën herë brenda një pike të rendit të ditës, dhe nuk ishte pyetje ajo por ishte diskutim për nga natyre, mirëpo nuk po dëshiroj të ndalem më shumë në këtë temë sepse këtë temë do ta trajtojmë në një mbledhje tjetër.

Më bëri të marrë fjalën diskutimi i kolegut z.Ragip Fetahut, vërtetë këtu jemi edhe për politikë por nëse zotëri Fetahu mendon që politikë është të bisedosh për arsimin në Komunën tonë, për vërshimet në Komunën tonë, për ujin e pijshëm në Komunën tonë, për sigurinë në Komunën tonë, për mbeturinat në Komunën tonë, nuk është politikë por është hall i qytetarëve që dikush dëshiron ta kalkuloj në politikë sepse më së lehti del ashtu. Përmenden kunja e fjalë kaubojshe e që unë tani nuk po përmendi kunja por po e tregoj një diçka tjetër që e përdorim e që është “cungun e mbram për shingjergj” e ai te mban atë kunj sepse i gjindet edhe atij.

Zotëri Kryetar tani kam një pyetje të drejtpërdrejt për ty, në debatin që kishim me znj.Jeta Xharra, vërtetë më ka bërë të ndjem keq gjendja e shkollës Llug, kjo pasi që u përmend shumë fshati prej nga vijmë ne dy Llugë, andaj ato pamje nuk më kanë bërë të ndjem mirë dhe qetë. E di që është investim i nivelit qendrorë, por a mund të shfrytëzohet ana kolegjiale dhe ana e bashkëpunimit me nivelin qendrorë kur dihet që i njëjti subjekt funksionon, dhe vërtetë a është tepruar me atë shkollë që mbi tri vite të mbahen fëmijët në atë gjendje çfarë janë. Unë nuk kam fëmijë aty po ka fëmijë të bashkëfshatarëve të mi, e që vërtetë është një situatë shqetësuese, mirëpo po mendoj dhe po shpresoj në atë që ti Kryetar e potencove se në muajin shtator do ta kemi të gatshme si objekt të ri në funksion, por deri tani që tri vite ata nxënës janë të cunguar qoftë sa i përket shfrytëzimit të oborrit të saj për nevoja rekreative qoftë për lojërë që fëmijët i bëjnë.

Kontrata Kolektive një diçka që ka zënë vend dhe që përmendet në vazhdimësi ku dikush e quan të pavend, dikush thot pse e kanë bërë, mirëpo nëse ne mendojmë se një qeveri në aspektin e vet të krijimit të kushteve më të mira qoftë edhe për pagë, e kanë nënshkruar një Kontratë kolektive me sindikatat për punëtorët e caktuar dhe ne që jemi këtu një pjesë e mirë e jona merr paga prej atij buxheti nuk e shohin si të dëmshme por kanë bërë padi për t'i shfrytëzuar ato të mira që dalin nga ajo Kontratë. Unë kurrë nuk do të doja të besoja dhe nuk e ndaj atë mendim që një kontratë ashtu qysh është që ka ndodh sigurisht që ka ndodh për nevojat e personelit ku qeveria është punëdhënëse, por unë krejt defektin e asaj mund ta shoh në atë që qeveria nuk e ka si veten kurrë atë kontratë kolektive dhe kurrë nuk mund të pajtoj që atë barrë t'jua hedh Komunave mirëpo është dasht ta zgjedh vet ajo sepse nënshkruese është vet qeveria.

Edhe njëherë e them se problemet jetike të qytetarëve nuk do të doja t'i trajtojmë si politike sepse fundja edhe nëse jemi për politikë jemi për politika lokale, tani janë zgjedhjet për nivel qendror.

Faleminderit Kryesues i Kuvendit me fjalën që kur të pyeti kolegu z.Ekrem Rrahmani a je lodh ti e the që jo sepse vetëm po dëgjoj dhe që vetëm për të dëgjuar jam, krejt e tregove.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, pasi u përmend emri kam vetëm një replikë të shkurtër me z.Naim Çunaku, unë e thash shumë qartë që secili ka të drejtë të shpërfaq mendimin e tij dhe natyrisht se biseda dhe komunikimi është ajo që na dallon prej qenieve tjera neve si qenie njerëzore.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kaluan dy-tri çështje si ajo e fushave sportive që u ceken, nuk e di pse u tha këtu që ka qenë tenderi 435,000.00€ dhe janë në përfundim, ndërsa ato fusha që po i shohë unë për çdo ditë në Kaçybeg dhe Sibofc nuk është rendi të përfundojnë, pastaj edhe fusha e sportit në Peran për të cilën kanë qenë dy tenderë, ku fillimisht ka qenë për fushë normale dhe nuk është kryer e mandej i kanë zvogëluar edhe dimensionet e që nuk e di kush ka guxuar t'i prek

dimensionet siç është thënë shkaku i disa shtëpive aty, pra është zvogëluar fusha për tu bërë pastaj jashtë standardit, madje edhe ajo fushë nuk mund të quhet e përfunduar.

U përmenden edhe drunjtë dekorativ edhe kjo është për çudi ngase në rr.”Skënderbeu” operatori që e ka pas tenderin për ta ndërtuar atë rrugë ka pas obligim edhe mbjelljen e drunjve dekorativ, por pastaj ka dal tender tjetër dhe ka shkuar andej, tender i cili ka mundur të jetë për të gjitha rrugët për tu vendosur druj dekorativ, kurse vetëm në atë rrugë (rr.Skënderbeu) jo sepse ende ne nuk e dim a është e përfunduar apo jo ajo rrugë, madje aq më tepër kur dihet që e njëjta kompani është e që nuk e di përse i është dhënë tenderi, përndryshe nuk e di a jeni në dijeni se ekziston një listë e zezë, andaj përse të njëjtës kompani t’i jepet pastaj ndërtimi i rr.”Xhemajl Mustafa”, rrugë të cilën kush e ka përcjellë është tenderua në muajt korrik-gusht 2023, më datë 01.09.2023 është dashtë të filloj puna, pastaj janë tejkaluar edhe afatet kohore sepse aty është shkruar 10 deri 12 muaj, andaj në kushte kur vonohet diçka nuk e di edhe çka duhet të bëjë ajo kompani për tu futur në listën e zezë, dhe mos t’i lë rrugët në këtë gjendje të fëlliqur kështu. Nuk e di a ka a ka rrugë që është punuar siç duhet, përndryshe rr.”Xhemajl Mustafa” dhe rrugë të tjera menjëherë pas lufte që kanë qenë disa kompani më të lodhëta i kanë ndërtuar më mirë rrugët e lëre tani 25 vite pas lufte të punohet kaq keq. Pra është dashtë të hiqet asfalti krejt, pasta të shkohet me 1 metër zhavorr, kurse ajo kompani ka bërë një lloj bay-pass midis vijës së bardhë dhe aty e ka vë një gyp të cilin e ka mbuluar dhe asgjë s’ka bërë dhe nuk e ka rregulluar asnjë gjë aty. Nuk e di kush është menaxher i projektit por mendoj se duhet të jetë më serioz dhe atë kompani ta fut në listë të zezë, e jo ajo kompani të vije dhe të na i fëlliq rrugët, qoftë rr. Skënderbeu” dhe tani edhe rr.”Xhemajl Mustafa”, rrugë këto të cilat janë kryesoret dhe të cilat i’u kanë besuar asaj kompanie e cila i ka punuar shumë keq.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, lidhur me atë që e tha z.Ragip Fetahu, vetëm e përgëzoj për ato thëniet e tij të famshme filozofike dhe vërtetë më bërë të ndihem mirë që sot mësova që qenie njerëzore është grada më e lartë apo siç e quajnë homosapiensisi.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ju dëgjova me vëmendje për të gjitha ato vërejtje të cilat i bëtë për punët ose në drejtim tonin si qeverisje lokale, mirë është, ato vërejtjet që janë me vend gjithsesi na ndihmojnë pozitivisht që ne të përmirësohemi në ato lëshimet që kanë mund të ndodhin në punën tonë. Një çështje, nuk është mirë që në aspektin elektoral të përdoret kjo foltore e Kuvendit por mirë do ishte të merreni veshë me ata të juajt ashtu siç janë marrë vesh ata të tjerët në mënyrë që të jeni barabartë me ata, mirëpo ke vendos (*i drejtohet anëtarit të Kuvendit z.Valon Demolli*) të vazhdosh me qenë këtu në Kuvend nuk është problem vazhdoje por mos e keqpërdor këtë foltore sepse të gjithë ata që nuk i shohin këto punë dhe këto projekte të mira, unë nuk kam ndonjë koment të veçantë.

Çështja tjetër, për zyrtarin e prokurimit, të LDK-së, por edhe për zyrtarët auditorët, të LDK-së, nuk kam ndonjë përgjigje sepse për krejt ato që i vlerësoj që janë të nevojshme tani publikisht e them që e keni padinë ndaj atij zotëriut, atij zëdhënësit tuaj që e keni bërë si “papagall”, tani e keni padinë dhe vazhdojmë me procedura gjyqësore për të gjitha që u thanë këtu dhe të cilat i ka thënë ai publikisht, mund ta shikoni atje e keni padinë zyrtare që sot është paraqitur publikisht.

Po ashtu prej një parafolësi u cek, projekte vizionare inovative, nuk e di a e kupton ai çka është vizioni dhe inovacioni, nëse një asamblist “për gjynah” i kësaj asambleje nuk e din që është vizionar parku industrial, që akumulacioni i Pollatës nuk është vizionar, pastaj nëse impianti i ujërave të zeza nuk është vizionar e që na kanë mbuluar ujërat e zeza në të gjitha anët, apo ndërtimi i shkollave nuk është vizionar, çfarë ti thuhet atij, çfarë përgjigje t’i jepet apo çfarë t’i them atij, ekonomistë, magjistër e çka jo, një krahë tituj.

Shkolla e fshatit Llugë vërtetë që është projekt i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe kontrata ka qenë e tillë e nënshkruar, por të mos ishte ajo kontratë unë do e rrënoja shkollën në

fshatin Llugë, dhe po ta rrënonim me siguri do të ndërtohej më shpejtë shkolla e re, mirëpo për t'i ruajtur ata fëmijë dhe për të mos i bartur qoftë në Batllavë ose Lluzhan unë kam dashur ta ruaj atë objekt, dhe ju e dini që e kemi vë edhe pozitën jo shumë të favorshme për të mos bartur ata fëmijë. Tani ky projekt është i paraparë dhe nënshkruar ashtu siç është dhe unë shpresoj që muaji shtator duhet ta na zë me atë projekt sepse është faza finale e punëve që do të kryhen dhe nëse askund nuk do të kish qejf të kryhen punët mirë, do të doja dhe do kisha qejf që ajo shkollë në fshatin Llugë të kryhet mirë, por është projekt që varet prej dikujt tjetër. Po jua them edhe këtë, janë ata inxhinier që e kanë përgatit atë terren ashtu, ata të Ministrisë që janë që 20 vjet aty dhe që dinë të kalkulojnë dhe e kanë lënë të tillë në ashtu, dhe ne domosdoshmërisht duhet t'iu përshtatemi.

Mandej uji, mbeturinat dhe gjërat tjera janë gjëra që vërtetë po na preokupojnë, e filluam me atë gypin F400 e i cili fatkeqësisht nuk ka shkuar në rezervuar por keni parasysht që uji nuk është projekt që unë mund ta zgjedh për 4 vite, po të ishte lehtë ju për 20 vite e kishit zgjedhë këtë problem, pra po të ishte uji problem i lehtë do e zgjidhte LDK e cila ishte 20 vjet këtu, ndërsa unë për këto 4 vite arrita ta filloj që të bëhet ai akumulacion dhe akumulacioni i Pollatës besoj se do e zgjidh problemin me ujë për qytetin e Podujevës, përndryshe deri sa nuk bëhet ajo zgjidhje unë nuk pres që mund të bëhet zgjidhje e qëndrueshme. Mund të bëjmë improvizime një gyp më shumë ose më pak, por nuk bëhet zgjidhje sepse atë ujë nuk mund ta dërgosh në fshatrat Kërpiç, Pakashicë, Revuç, Metehi e të tjera, ne do të donim dhe do kishim qejf ta zgjidhnim këtë problem ngase sot e kësaj dite kemi reduktime të ujit në mbrëmje ngase po nuk u mbush ai rezervuari aktual nuk ka ujë ditën pastaj, prandaj nuk është problem që zgjidhet lehtë.

Sa i përket mbeturinave, unë mendoj që të gjithë ata që dëshirojnë ta shohin pastërtinë në Podujevë, shkoni merreni shembull Prishtinën dhe ejani e këqyreni Podujevën, ju e keni qeverisjen atje në nivel lokal dhe shikojeni Prishtinën e pastaj ejani në Podujevë merrni shembull të mirë.

Në Gjilan shumë rrallë shkoj, por mund shkoni edhe në Fushë Kosovë dhe e keni modelin e qeverisjes tuaj dhe shikojeni cili e ka gjendjen më mirë. Unë nuk po them që është perfekt sepse larg përfektes jemi por ka zhvillime pozitive, ka projekte të rëndësishme të cilat besoj se qytetarët janë duke i përqaftuar, duke i parë dhe duke i prekur, ndërsa a jemi perfekt, nuk jemi kemi gabime apo lëshime, por edhe ka pengesa nganjëherë dhe madje nga ato që vet nuk i dëshirojmë por që ndodhin rrugës. Është mirë ta përmendni edhe një element pozitiv që duket sepse pastaj bini keq para qytetarëve sepse ata ju shohin, ju përcjellin, por nuk është problem, unë po mundohem të jem shumë korrekt me gjitha ato që janë bërë përfshirë këtu edhe problemet të cilat na kanë përcjellë gjatë, por nëse ju shihni veç zi, nuk po di çfarë të them dhe çfarë përgjigje t'ju jap.

U cek edhe performanca, nëse ndokush mund t'i numëroj komunat që kanë përfituar në performancë urdhëroni, përndryshe një keq kualifikim e rrëzon performancën, një heqje e parasë prej projekteve që na ka ndodh në këtë vit për kontratën kolektive, nuk mund të kesh performancën. Përndryshe ne kemi mbi 99% shpenzim të buxhetit dhe jemi pozitiv por nuk mund ta fitojmë performancën ngase kemi 5,000,000.00€ që na janë heq qoftë prej pagave apo projekteve të ndryshme kapitale ku disa prej projekteve janë goditur seriozisht, mirëpo tjetër gjë është niveli qendror dhe mundësia e bashkëpunimit me Ministrinë përkatëse e që kemi arrit t'i amortizojmë këto ngase prej 9,000,000.00€ të hiqen/merren buxhet kapital në shumë 5,000,000.00€ dhe të menaxhohet mirë e suksesshëm në përmbyllje të këtij viti nuk është e lehtë, por ja që ne e përmbyllëm dhe atë besoj me rezultate të shumta pozitive që janë të prekshme për të gjithë qytetarët tanë, mirëpo për dikë mund të mos duken dhe të mos shihen.

Ka operator ekonomik me të cilët kemi telashe siç është ai i ndërtimit të fushave sportive me të cilin kemi telashe e që i njëjti operator është edhe ai rrugës lidhëse Magjistrale me rr.“Vëllezërit Frashëri”, pra pati mundësi të kryhet por që nuk u krye, pa fajin tonë, por me faj të operatorit që

nuk e kryen punën, ashtu siç edhe kemi telashe edhe shumë kompani tjera që janë duke operuar dhe jo vetëm ne si Komunë por kanë telashe po thuajse gjithandej Kosovës sepse këto nuk janë as Bechtel Enka e as kompani tjera me reputacion çfarë i kanë të tjerët, andaj si rezultat i saj po ndodhin këto gjëra.

Pra bëni durim sepse viti i ardhshëm është vit zgjedhor dhe të vijnë zgjedhjet ne do të fillojmë të punojmë me këto kapacitet tona ndërsa ju aq sa mundeni kritikoni dhe në fund e marrim një rezultat prej qytetarëve.

**z.Fatmir Gashi**, theksoi, unë nuk mora përgjigje për pyetjen që ta bëra më parë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, vazhdoi, është intervenuar në 634 raste nga zjarrfikësit edhe përkundër numrit shumë të vogël të stafit që kemi, atë staf që aty e kemi gjetur nuk kemi arrit ta zgjerojmë për shkak të kufizimeve buxhetore, përndryshe mendoj që e kanë kryer një punë të jashtëzakonshme dhe të suksesshme gjatë kësaj periudhe kohore.

Vera nuk ka qenë e lehtë sepse ka pas shumë zjarre dhe ka pas shumë intervenime tjera, madje kemi pas raste ku është dashur domosdoshmërisht të kërkojmë ndihmë nga niveli qendror në Prishtinë e që edhe kemi marrë ndihmë ndihmë ngase nuk kemi mundur t'i mbulojmë rastet me ato kapacitete që kemi. Përndryshe sa i përket kushteve të tyre, ne kemi punuar në kuptim të infrastrukturës atje për të pasur kushte të përshtatshme dhe ju e dini gjendjen çfarë e keni dorëzuar dhe e dini se ajo gjendje është më mirë tani se sa që ka qenë atëherë qysh e kemi gjetur.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, Kryetari i Komunës përmendi krejt këto çka than kolegët e mi, por unë atë që e ceka ishte më e ndjeshme sesa gjitha këto, por atë nuk e përmendi, madje Kryetari e tha që 99% të buxhetit e kemi shpenzuar, andaj pyes a nuk ka mund të gjendet pak buxhet aty për transport të atyre fëmijëve, apo patjetër duhet me marrë dikë që është i afërt a dikë që donë me punu atë punë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nëse mund t'i përgjigjem parafolëses, sa i përket transportit nuk është që kemi pas të afërm sepse ju e dini ai që i ka transportuar është një prej njerëzve tuaj për të mos thënë i subjektit tuaj politik, pra nuk ka qenë i yni por arsyeja është se ka ankesa dhe lënda ka shkuar në ankesë, por ne kemi bërë një solucion alternativ dhe për ata fëmijë kemi ndarë një shumë të mjeteve Hendikosit në mënyrë që të kenë mundësi t'iu ndihmojnë rasteve të tilla dhe asaj kategorie. Pra është OJQ-ja me shumën më të madhe të mjeteve buxhetore që kemi ndarë nga subvencionet, po ashtu edhe një shumë e madhe është ndarë edhe për fëmijët me autizëm për të cilët kemi bërë përpjekje t'iu krijojmë kushte optimale për të pas mundësi ta zhvillojnë procesin.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, i nderuar Kryetar i Komunës, a mjaftojnë 9000€ për ata fëmijë, ne e dimë që kemi dy shkolla me fëmijë me nevoja të veçanta dhe nuk besoj që mjaftojnë 9000€.

Nuk e di kur janë dhënë ato para, por qe 6 javë ata fëmijë të mos kenë transport është shumë për ata fëmijë të cilët e dim që janë bashkë në një vend sikurse ata me autizëm, sindrom down, e kjo nuk duhet të jetë ashtu.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, vazhdoi, unë fola për OJQ-në "Hendikos" që i është ndarë një shumë e mirë, nuk fola për ata fëmijë, sepse ata fëmijë janë brenda SHFMU "Kongresi i Manastirit" në fshatin Gllamnik dhe brenda atij objekti funksionojnë dhe shpenzimet i kanë të përbashkëta me të gjithë fëmijët tjerë, do të thotë ndahen mjete dhe financohen nga buxheti për shërbime dhe mallra brenda DKA-së.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, meqë Kryetari e përmendi Hendikosin për të cilën e tha që është ndarë një shumë për transportin e atyre fëmijëve, por sa kam informata unë nuk është e vërtetë, ne shumë shpesh e kemi kërkuar në Kuvend dhe kemi thënë se shuma që është subvencionuar Hendikos është shumë e vogël. Po ashtu nuk e kanë pas në projekt bartjen e nxënësve dhe ju ua

keni shtuar këtë pa e pas fare në projekt, do të thotë nuk i keni subvencionuar më shumë subvencionuar më shumë për t'i bartë nxënësit.

Gjëja tjetër është se objekti që ia keni dhënë në shfrytëzim minimalisht i plotëson kushtet por jo të gjitha, pastaj oborri është pa rrethoja, mbeturinat hidhen çdo ditë, gjendja e tyre është jashtëzakonisht e keqe dhe këtë Kryetari e din më mirë se unë. Gjithashtu nga një i anëtarësuar aty kam marrë informatën që i'u ke premtuar 10 personave që do ti dërgosh në qendrën rehabilituese Banja "Nëna Naile" për Jka pyes a e ke realizuar këtë premtim për ata anëtar të Handikos.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** duke i'u përgjigjur parafolëses, theksoi, për çdo vit kam ndarë mjete financiare dhe jo vetëm për Shoqatën "Hendikos" dhe i kam dërguar nga 10 persona në qendrën rehabilituese, mirëpo këtë më saktë mund ta di drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dh Mirëqenies Sociale, e cila edhe do t'ju jap përgjigjen më sakt rreth kësaj pyetje.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, së pari nuk është dashur të keqpërdoret foltorja me "papagalla", "ç'papagalla" dhe se me kë don të përballet ai (Kryetari i Komunës) nëpër gjykata, nëse s'është anëtar i Kuvendit s'ka nevojë ky të na tregoj neve dhe se fare nuk do të na tutë për atë punë hiç, veç në gjykatë le të rrin sepse në fund vet atje do të përfundoj.

Projektet që i përmenda unë nuk mora përgjigje për asnjërën, kurdo që dëshiron le të del Kryetari në njërin anë e unë në anën tjetër dhe përballemi me dokumente një nga një dhe tani e din ai a janë shpifje apo jo ngase këto dokument nuk i kam bërë unë, prej faqes së Komunës i kam shkarkuar dhe vetëm i kam nënvizuar dhe i kam shikuar procedurat. Pra asnjërin projekt nuk i përmendi, as rr."Skenderbeu" e as rr."Xhemajl Mustafa", ne nuk kemi ardh këtu t'i themi mirë e ke këtu mirë e ke aty edhe pse ka servilë të tillë që kënaqen duke i thënë e që i'u kanë mërzhitë edhe këtij duke i shkuar mbrapa e duke i thënë mirë e ke, i mirë e i hjeshëm je, përndryshe ne do t'i gjejmë vërejtjet edhe nëse kjo ju pengon kështu, përndryshe për çfarë jemi ne këtu, nëse dëshironi me na sjellë komunizëm këtu sikurse "Xhaxhi Enver" mund edhe t'ju duartrokasim dhe t'i rrahim bankat këtu. Po ashtu unë e pata edhe një pyetje se kush i ka futë duart në Gjeoportali duke i ndërruar emrat e rrugëve, do të ishte mirë të më përgjigjeni sepse janë duke pritur njerëzit t'ju tregojmë a është prej tij a prej kujt, pse dhe në çfarë mënyre, përndryshe ndoshta unë jam gabim dhe le të më argumentoni ju, nëse është dashur ashtu dhe nëse procedura është ashtu, unë pajtohem.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** përgjigje parafolësit, theksoi, shkurt ju tregoj që unë nuk jam bartës i Gjeoportalit dhe nuk merrem me gjeoportalët, ata që kanë kompetenca në Gjeoportali le të shkojnë të marrin informata në Gjeoportali, por jo tek unë.

**z.Naim Çunaku,** theksoi, i nderuar Kryetar, rreth raportimit apo rreth realizimit të projektbuxhetit që është miratuar në shtator të vitit të kaluar, mendova që do ta bëjmë një debat pa i dhënë kahe politike sepse në atë moment që i jep kahe politike në një formë veç ka për të fsheh diçka.

Diçka që më bëri përshtypje e që nuk më pëlqen Kryetar ishte krahasimi me Prishtinën, me të vetmin qëllim po e them pa politikë. Në vitin 2000 ku për herë të parë është themeluar ky Kuvend ne kemi elaboruar me shifra që Komuna e Podujevës i ka 130000 banorë, po flas për vitin 2000, pastaj në vitin 2017 komuna e Podujevës ka rënë në rreth 84000 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit ne kemi 71000 banorë, dhe kur përdorim metodë krahasuese unë e di që ju jeni më të zot në këtë kuptimin profesional qoftë ti Kryetar qoftë Kryesuesi. Pra numri i banorëve në Komunën e Podujevës vazhdimisht ka rënë, migrimi dhe emigrimi e kanë bërë që Komuna e Podujevës fare të mos e llogaritë natalitetin, ne vetëm prej vitit 2017 deri në vitin 2024 kemi rënie mbi 13000 banorë, shtu këtu edhe natalitetin i bie që kemi një rënie mbi 20000 banorë, dhe të bësh krahasime me Prishtinën dhe Fushë Kosovën që janë duke u mbipopulluar nuk na çon te rezultati i drejtë.

Kur fola për shkollën e fshatit Llugë, i nderuar Kryetar nëse më ke dëgjuar me vëmendje thash është i ditur projekti por unë pyeta a mund të gjenden mundësi për t'u përshpejtuar puna që të paktën në muajin shtator të kryhen punimet.

Këtu u fol shumë edhe për fëmijët me nevoja të veçanta, vërtetë nuk jemi duke i'u kushtuar kujdes, në bazë të statistikave të vitit 2017, mbi 1% e popullatës së Komunës së Podujevës është me nevoja të veçanta dhe po të hyjmë tash tek krahasimet a jemi duke bërë mjaftë për ata persona për të cilët vetëm ato familje që i kanë brenda dhe përballen me ta e dinë mundin që duhet për një rritje aso fare, mirëpo unë krejt këtë e kisha edhe kur e patëm pikën e parë të rendit të ditës e që qëllimi ishte që ne sa më shumë t'ua lehtësojmë atyre jetën.

Ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe jemi të obliguar që zërin dhe shqetësimet e tyre t'i ngrisim këtu, jam prej atyre që kam ditë gjithmonë t'i them të bardhë së bardhë dhe të zezës të zezë, dhe kalkulimet që u bënë se jemi në fushatë dhe dikush sikurse ky kolegu im (z.Valon Demolli) nuk ka dhënë dorëheqje, mirëpo i ke edhe në anën e djathtë andej kandidat që nuk kanë dhënë dorëheqje, andaj po më duket që po e politizojmë vetë një diçka që nuk është dashur të jetë politike.

Për fund, do të isha shumë më rregull që ky raportim ta ketë një material për ta përpunuar më gjerë sepse nuk mundesh këtu për këtu ta përpunosh.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se për këtë pikë të rendit të ditës debati përfundoj.

Meqë po vërej se ka kërkesa për një pauzë, kusj jeni që të shkojmë në pauzë për rreth 1 orë, përkatësisht deri në ora 14:00, por që të mos ketë vonesa në vazhdimin e mbledhjes.

*Pas kërkesave për pauzë, Kryesuesi konstatoj se Njëzëri mbështetet që të shkohet në pauzë për 1 orë dhe atë nga ora 12:50, dhe njëkohësisht duke bërë thirrje që mbledhja të vazhdon në ora 14:00, të mos ketë vonesa.*

**Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 14:25.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.

Nga PDK, Endritë Murati; Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Arbnor Fazliu.

Të pavarur, Demokrat Hodolli,

Gjithashtu të pranishëm në mbledhje ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Administratës DA; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;)

Të pranishëm tjerë ishin edhe përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**2. Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevë (vazhdim i diskutimit nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 11.12.2024)**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ka qenë kërkesë që kjo pikë të jetë në rend të ditës për këtë mbledhje në mënyrë që të diskutohet më gjerësisht, kështu që urdhëroni e vazhdojmë diskutimin.

**z.Ragip Fetahu**, në cilësinë e iniciuesit të kësaj pike, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, së pari dua të theksoj se jam duke e parë një papërgjegjësi shumë të madhe të kolegëve të mi nga opozita sepse u kthyen në sallë kur u bë kuorumi dhe duke e pasur parasysht një çështje kaq të rëndësishme për neve dhe rinin tonë dhe për qytetarët e Komunës së Podujevës është e pa logjikshme dhe e pa arsyeshme që të bëhet kjo.

E dyta që kam është një kritikë ndaj Drejtoreshës së Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila që dy herë folet për këtë çështje dhe nuk gjendet këtu në sallë, pra është diçka e pa justifikueshme që dy herë të folet për këtë çështje dhe ajo nuk gjendet këtu për të marr fjalën e saj dhe përgjegjësit e saja të cilat i takojnë e që është e pa arsyeshme sepse një çështje e tillë ku fenomenet negative të të rinjve që na prekin të gjithëve duke përfshirë familjet tona dhe të gjitha gjeneratat, prandaj është e pa justifikueshme mungesa e saj në këtë mbledhje të Kuvendit, pra ose duhet të kryhet puna me përgjegjësi ose duhet t'i jepet ndokujt mundësia që ta bëjë atë punë si duhet.

Të respektuar koleg, arsyeja e propozimit tim për këtë çështje është se duke i parë të gjitha ato përhapje të fenomeneve negative tek të rinjtë tanë, siç janë dhuna, përdorimi i armëve si dhe droga, ashtu siç edhe jeni në dijeni edhe ju nga materialet që kanë të bëjnë me këtë çështje i kam dërguar përmes Kryesuesit dhe është dërguar tek ju me e-mail. Po ashtu edhe statistikën e Policisë së Kosovës të cilat më janë dhënë mua i kam përcjell me e-mail, gjithashtu edhe rekomandimet e mia që i kam potencuar në mbledhjen e kaluar i keni të listuar në e-mail.

Është shumë e rëndësishme që të gjithë ne të bëjmë më të mirën në mënyrë që këto fenomene t'i ndalojmë dhe të gjithë së bashku të diskutojmë për një të ardhme më të mirë në mënyrë që në vitin e ardhshëm të fillohet me masa konkrete nga Drejtoritë përkatëse, ku e ri theksoj nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport të ketë një qasje më serioze komform rregullave të përgjithshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes, gjithashtu edhe Drejtoria e Arsimit e ka përgjegjësinë që të merret më seriozisht me këtë çështje. Kur e kam ngritur këtë çështje e kam menduar dhe e potencoj sërish se kjo çështje nuk ka të bëjë me politikë, pra nuk është çështje politike dhe nuk bëhet për inate apo mendime individuale, por kjo çështje bëhet për interes të përgjithshëm me qëllim të ruajtjes së rinisë së shëndosh, pra një rini të cilën e kemi pas dhe e kemi përgjithësi të ruajmë atë ashtu siç e kemi pas dhe siç e kemi me qëllim që të kemi gjenerata të ardhshme të shëndosha dhe të punojmë të gjithë së bashku për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit ton.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, të nderuar koleg, vërtetë këtë temë e kemi trajtuar në seancën e kaluar dhe ishte një dakordim i të gjithëve që në bazë të kompetencave që kemi çdo njeri nga ne të mundohet të jap kontributin e tij në luftimin e këtyre dukurive shoqërore dhe me theks të veçantë te moshat e reja. E dëgjova me vëmendje zotëri Fetahun dhe nuk mund të pajtohem me atë që cili grup politik nuk po dëshiron të bëjë kuorum, para se të gjithash në rend të parë kuorumin duhet ta siguroj partia në pushtet, se kjo dukuri është shqetësuese në veçanti për ne në këtë rast në rolin e opozitës, e kemi kontributin ton dhe po e japim edhe sot e nesër e gjithmonë që për neve këto dukuri janë shqetësuese dhe asnjë nga ne, as më të voglin hezitim nuk kemi kursyer asgjë nga vetja që sado pak të kontribuojmë në zbutjen apo eliminimin e këtyre dukurive, por kjo pikë e rendit të ditës i nderuari Fetahu me gjithë respektin për angazhimin tuaj personal në atë që të ka munduar sepse është edhe mundim i të gjithë neve dhe ta propozosh për një zgjidhje ose dhënien të një alternative se si vërtetë në këtë segment të përkrahi, mirëpo të mos harrojmë që roli i Kuvendit të Komunës është në kërkim të llogarisë nga akterët që kanë përgjegjësi institucionale për luftimin e këtyre dukurive të devijuara dhe është për keqardhje për akterët institucional që e kalojnë në heshtje dhe detyrohet dikush nga Kuvendi i cili në vend që të kërkojë llogari pse është këtu, të marr hapa dhe të tregoj vullnetin e tij dhe të rreshtohet në krah me gjithë institucionet e sigurisë në luftimin e këtyre dukurive e që për këtë edhe njëherë e theksova që të përgëzoj derisa për të parën nuk pate të drejtë.

Ju si propozues zotëri Fetahu sigurisht që duhet të keni një deklaratë sipas asaj që e kam lexuar në material dhe mund të merret një pjesë e saj si deklaratë shumë e saktë sepse fundja në atë material i bënë thirrje institucionet relevante që duhet të merren me këtë por ne kemi të dhëna të një kolegu ton që thirret në burime të besuara nga ai dhe ne e marrim si gjë të mirë vetëm atë që e kemi marr nga kolegu, ndërsa Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, Drejtoritë që i ceka më herët siç janë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Arsimit, të cilat nuk e kanë dhënë asnjë fjalë dhe përgjegjësia është mbi to. Për këtë që është duke u diskutuar ne mund të dalim me një deklaratë zotëri Fetahu, qoftë e përgatitur prej teje apo në bashkëpunim me grupet tjera ku besoj që do të jenë bashkëpunues dhe grupet tjera dhe ne mund të bëjmë atë deklaratë, përndryshe diçka tjetër nuk mund të bëjmë rreth kësaj çështje dhe në një formë të sensibilizojmë dhe të dërgojmë sinjal edhe te prindërit, shkollat dhe institucionet një përkrahje që të bashkëngjiten të gjithë me kontributin e tyre që këto dukuri të kenë efekt sa më minimal në progresin e shoqërisë ton.

**z.Haki Rudari**, theksoi, kolegu apo propozuesi i kësaj pike natyrisht që i theksoj të gjitha ato dhe ka mbështetjen e Grupit të LVV-së për të gjitha që u theksuan, por unë duke ardhur nga fusha e arsimit dua që të theksoj disa çështje për arsyeje se dhuna afër shkollave, pastaj përdorimi i drogave dhe çështjet tjera është dukuri negative në të gjitha shkollat, e them këtë në kuptimin në të



gjitha Komunitat dhe ky problem nuk është vetëm në Komunën tonë por ne po e shohim nëpërmes mediave që dhunë e pasiguri po ka edhe në shkollat që janë në Komuna tjera.

Unë mendoj që secili duhet të veproj në bazë kompetencave që ka e ne si Kuvend kemi kompetenca të debatojmë dhe në fund siç e cekën parafolësit mund të dalim me një deklaratë me disa pika ku besojmë kemi të drejtë dhe është mirë të bëhet.

Ndërsa sa i përket Ekzekutivit të Komunës që u përmend, po është e vërtetë duhet të ketë seriozitet çdo kush në Ekzekutiv, unë po e shoh këtu drejtorin e Drejtorisë së Arsimit vazhdimisht prej fillimit të seancës është prezent mirëpo secili nga Ekzekutivi duhet të dijë mekanizmat që duhet të merren në mënyrë që të kemi një siguri sa më të madhe në shkolla. Mendoj që ato propozime që do ti jap në fund të debatit kolegu z.Ragip Fetahu do të votohen pa ngjyrim politik për arsyeje se siguria apo mos siguria në shkolla nuk ka ngjyrë politike, secili mund të jemi prindër dhe të kemi fëmijët në shkolla dhe secili prindër e ka një drojë derisa të kthehet fëmija në shtëpi, prandaj në këtë vij mendoj që duhet të kemi një debat të shëndosh dhe pa ngjyrim politik, unë kështu e shoh. Po ashtu edhe Këshilli Komunal për Siguri Bashkësi duhet të jetë më aktiv dhe të merret me këto gjëra sepse është mekanizmi përfundimtar në këtë Këshill, por megjithatë ne si Kuvend i Komunës e kemi obligim dhe po besoj që në fund do të ketë dakordim për pikat në mënyrë që të vazhdohet.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, një temë sa e ndjeshme aq edhe e rëndësishme dhe e nevojshme për të diskutuar dhe për të ndërmarr veprime për parandalimin e tyre. Shumë veprime të rëndësishme që duhet të ndërmerren janë potencuar në raportin e pranuar nga iniciuesi zotëri Fetahu.

Padyshim faktor kryesor i cili do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin dhe parandalimin e këtyre dukurive është familja, pra bashkëpunimi në mes shkollës, drejtorit, mësimdhënësve dhe prindërve është shtylla kryesore. Prindi duhet t'i kushtoj rëndësi arsimimit të fëmijës së vet dhe duhet të përfshihet dhe të marr pjesë në takime ose mbledhje të prindërve dhe të mbaj kontakte të vazhdueshme me shkollën lidhur me performancën e fëmijës së tij.

Veprimet tjera të sugjeruara e që janë të nevojshme sipas mendimit tim do të ishin rritja e numrit të psikologëve në shkolla, shtimi dhe punësimi i sigurimit fizik të trajnuar sidomos për shkollat e mesme të qytetit, të pajiset stafi i shkollës me detektor të metaleve, ata pra të cilët e hapin derën e shkollës në mënyrë që të bëhet një kontroll i nxënësve me detektor të metaleve, pastaj për trajtimin e bullizmit si fenomen në rritje në shkolla tona, në ambientet e shkollave tona në korridore të bëhet vendosja e disa posterëve anti bullizëm dhe të cilët i nxisin fëmijët që të raportojnë rastet, pra të ngritët vetëdijesimi i fëmijëve kundër kësaj dukurie. Tek uniformat për nxënësit dhe për mësimdhënësit unë sugjeroj që kush do që të jetë vizitor i shkollës që mund të jenë prindërit, zyrtarët nga Drejtoria e Arsimit apo kush do qoftë tjetër, të pajisjen me një mjet identifikues që të jenë vizitor me leje nga shkolla.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, është për të ardhur keq që në Komunën tonë po përballemi me një rritje shqetësuese të dukurive negative në mes të rinjve siç janë përdorimi i drogave, alkoolit dhe dhuna ndaj nxënësve, ndërkohë Komuna jonë nuk ka ndërmarr asnjë hap konkret për t'i parandaluar këto dukuri. Mungesa e angazhimit të institucioneve lokale ka lënë hapësirë që këto probleme të përhapen dhe të dëmtojnë seriozisht brezin e ardhshëm, konkretisht e kam fjalën për Komunën tonë ku për vite me radhë kemi parë vetëm premtime boshe dhe plane të paqarta, por që në realitet nuk janë organizuar mjaftueshëm fushata profesionale si ndërgjegjësimi për rreziqet e drogave alkoolit dhe pasojat e dhunës. Mandej nuk janë krijuar hapësirat e sigurta për të rinjtë, nuk ka as programe dhe këshillime profesionale për nxënësit që përballen me sfida sociale apo emocionale, shkollat nuk kanë marr mbështetje të mjaftueshme për të trajtuar konfliktet dhe për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurtë. Mungesa e veprimit nga ana e Komunës është një neglizhencë e pafalshme, Institucionet lokale duhet të jenë të parat që veprojnë për të mbrojtur të rinjtë nga ndikimet e

dëmshme dhe për tu ofruar atyre siguri dhe të mira për të ardhmen. Nëse Komuna jon nuk e ndryshon këtë qasje dhe nuk ndërmerr hapa të qartë dhe të menjëhershme duhet të jetë bashkëfajtores për të gjitha këto dëme që po i pësojnë të rinjtë e tanë dhe brezi jon i ardhshëm, prandaj mendoj se është koha që ju të mbani përgjegjësi duke filluar nga Drejtoria e Arsimit që asnjëherë që tri vite nuk ka raportuar për këto dukuri.

**z.Fatmir Gashi**, theksoi, unë edhe pse nuk jam i pajisur me materialin përkatës për këtë pikë të rendit të ditës megjithatë po e shoh të arsyeshme që t'i theksoj disa fjalë për këtë dukuri.

Si iniciativë është e nevojshme dhe e domosdoshme për arsyeje se ne e dimë që këto dukuri të dëmshme shoqërore që nga viti 1990 e kanë prekur hapësirën gjegjësisht vendin ton. Për fat të keq ne e dimë se cilët janë faktorët që ndikojnë më së shumti në përhapjen e këtyre dukurive, me theks të veçantë po e them për drogat, sepse kjo e keqe tek ne është importuar dhe ka qenë një mjedis vërtetë i shëndosh dhe i ruajtur deri në vitet 1990 e këtej. Sidomos aty ku është papunësia dhe varfëria e madhe ne e dimë në kushtet e okupimit se si kemi vepruar, pastaj mungesa e prindërve që nga familja duhet të inkuadrohet si faktor kryesor së bashku me institucionet tjera ku fatmirësisht tani kemi institucionet përkatëse që merren me këto çështje, pastaj e kemi Strategjinë për këtë çështje në nivel kombëtar që është e punuar prej vitit 2012 deri në vitin 2015 nëse nuk gabojmë, që është për parandalimin dhe marrjen e masave të tilla si dhe kemi Planin e veprimit për këtë Strategji. Përveç kësaj kemi pas probleme të mëdha sepse nuk kemi pas as individ apo kuadër të mjaftueshëm njerëzor dhe as infrastrukturë institucionale për trajtimin e këtyre çështjeve e sidomos të konsumimit të drogave, kështu që tani e di që janë 5 Qendra, përveç Qendrës Kryesore janë edhe 4 të tilla në rajonin e Kosovës që merren me trajtimin e kësaj çështje.

Ne po jemi në dijeni që kjo dukuri është në rritje e sipër dhe nuk po flasim në aspekt ndërkombëtar sepse është rrjet aq i organizuar që paraqet shqetësime të mëdha e deri te vendet e zhvilluara kjo ka filluar shumë më herët me vite të tëra, për fat të keq kemi qenë me kushte të pa mbrojtura por duhet të jemi të vetëdijshëm sepse mund të jetë koha e fundit që vërtetë të ulemi me të gjithë faktorët relevante që nga familja e deri te ato përkatëse që janë të obliguara me ligje dhe norma të bëjmë diçka më mirë për parandalimin e kësaj dukurie që mund të na godas në shumë aspekte, nga ai që e përdor dhe dihet se ku e dërgon, krijohen raste të papunësisë dhe shqetësime tjera, prandaj si iniciativë e përkrah edhe unë dhe të gjithë ata që e duan vendin e vet dhe të ardhmen do të apeloja që të bëjmë çfarë do që të mundem për parandalimin e këtyre dukurive, me theks të veçantë të drogave sepse është një e keqe që e godet tërë botën dhe neve, pra jemi në fazën që ne mund të bëjmë diçka ende më shumë dhe tani kemi edhe përvojat dhe institucionet dhe duhet t'i shfrytëzojmë, sepse edhe mekanizmat përkatës pa përkrahjen e nivelit qendror është problem të luftohet kjo dukuri sepse duhet të jenë njësitë përkatëse në Ministri të ndryshme të cilat duhet të jenë sa më shumë azhure dhe efikase, ne e dimë që në shumicën e rasteve të zbulimit kur vijmë te këto raste mekanizmat ton rastësisht e zbulojnë, pra shkon dhe kërkon për diçka tjetër dhe ndeshet me substancat e ndaluara.

**znj.Edonë Shabani**, theksoi, e përgëzoj kolegun z.Ragip Fetahu për këtë iniciativë dhe i propozoj që nëse ka nevojë për neve lidhur me këtë fenomen, unë personalisht jam e gatshme ta përkrah edhe në mënyra tjera, ndërsa sa i përket Drejtorive të Komunës e kam një mendim sepse kjo shkon si trekëndësh, profesor-kujdestar klase-prindërit dhe drejtor. Problemi është që bullizimi fillon qysh në shkollë dhe nuk fillon jashtë shkollës sepse së pari profesorët i favorizojnë shumicën e nxënësve duke ju thënë që ti je “djali i filanit” dhe ti mund të bësh çka duash, pra ne duhet ta nisim këtë nga shkolla dhe jo jashtë asaj, në qoftë se jemi të gjithë bashkë, edhe pse nuk do të largohet i gjithi si fenomen por mendoj që do të ulet dhuna në shkolla dhe mendoj që do të jetë më atraktive për të gjithë. Pra zotëri Ragip, na duhet të fillojmë së pari nga brenda shkolle sepse ka prindër që

nuk e dinë që fëmija i tij është problem sepse nuk e lajmëron askush, në qoftë se fillojmë nga brenda shkollës dhe nëse drejtori i Drejtorisë së Arsimit na jep leje, ose ty personalisht, të fillojmë të bisedojmë me kryetar të klasës, atëherë besoj që do të arrihej shumë.

**znj. Donjetë Sheqiri**, theksoi, në seancën e kaluar kur kemi kërkuar që ta shtyjmë këtë pikë, kam kërkuar prej teje raporte nga akterët kryesor, ne e kemi marr një raport me mirëbesim që mund t'i besojmë, por nuk është zyrtar sepse raporti zyrtar duhet të posedoj vulën e institucionet përkatës, pra unë kam kërkuar raport nga institucioni i Policisë, nga Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, kështu që të lutem për herën tjetër kur kemi kërkesa të tilla, e them këtë sepse me këtë arsyeje e kemi shtyrë këtë pikë për seancën e radhës, pra kur i kemi këto kërkesa është mirë që të përfille i nderuar Kryesues dhe jo të na vije një material i cili është i përpunuar, nuk po e them që nuk është i saktë por të paktën duhet të jetë zyrtar sepse ne jemi zyrtarisht këtu.

**z. Avni Fetahu**, drejtor i DKA, theksoi, fillimisht e falënderoj iniciatorin e kësaj teme që është mjaftë me rëndësi por edhe të gjithë juve që keni kontribuar për këtë temë mjaftë të rëndësishme. Ne si Drejtori jemi munduar të krijojmë një ambient gjithëpërfshirës për nxënës dhe mbi të gjitha të sigurt e po ashtu edhe miqësor, dhe në kuadër të kësaj edhe mbledhjet që i kemi vazhdimisht me drejtorët e shkollave si temë e veçantë është edhe siguria në shkolla dhe masat e parandalimit të dhunës në shkolla si dhe fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkollë.

Me keqardhje e them duke filluar nga Këshilli i prindërve që asnjëherë nuk është zgjedhur në formë transparente siç është zgjedhur në mandatin e kaluar e që tani në këtë vitin që po hyjmë bëhen garat e reja dhe i inkurajojmë të gjithë ata që angazhohen në Këshill të prindërve që është një rol shumë i rëndësishëm dhe të japin kontributin e tyre. Pra zgjedhjet do të mbahen dhe mund të marrin pjesë çdo prindër që ka fëmijë në shkolla. Si Drejtori e Arsimit atë që e kemi paraparë të nevojshme në fillim të mandatit ka qenë zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik, ju e dini që në krejt Komunën e Podujevës i kemi pasur 3 psikolog dhe aty ku anëtarja e Kuvendit që e ka përfunduar shkollën ku e potencoj më herët pra e ka kryer shkollën për tri vite radhazi pa e pasur psikologun në shkollën, problematikë që ka qenë dhe tash është psikologu aty, pra prej tre psikologeve tash i kemi 9, dhe Udhëzimi Administrativ e thotë që nga 1000-1500 nxënës duhet ti ketë shkolla me qëllim që të ketë psikolog, megjithatë ne jemi munduar ti inkurajojmë ata që të punojnë edhe në shkolla tjera në mënyrë që të mbulohet tereni.

Përveç kësaj në Komunën e Podujevës e kemi pasur vetëm një pedagog në 40 objekte shkollore dhe sot i kemi 3, i kemi pasur vetëm 3 asistent për fëmijët me nevoja të veçanta kurse tani kemi 17 dhe kjo nëse nuk është e arritur dhe nëse konsiderohet që nuk është bërë asgjë atëherë duhet të shohim me tjetër format.

Edhe te sigurimi i transportit të nxënësve përveç tani që ka ndodhur që ka shkuar në ankesë çështja e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta i vetmi Lot, ne probleme të kësaj natyre nuk kemi pas dhe vitin e kaluar janë bartur nxënësit, ndërsa këtë vit ka dal ky problem që urojmë në fillim të vitit të rregullohet. Te siguria e nxënësve ka qenë e nevojshme edhe ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore, posaçërisht rinovimi i objekteve, gjithashtu edhe rregullimi i rrethojave të shkollave, po ashtu edhe ndërtimi i trotuareve për këmbësor që e kemi bërë në bashkëpunim me Drejtorin e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që e kemi realizuar.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Arsimit me Policin e Kosovës, vetëm nga periudha shtator deri më tani janë mbi 100 trajnime që janë mbajtur në bashkëpunim me Policin e Kosovës, ku mund t'ia kërkon informatën Policisë ku ata kanë mbajtur trajnime për dukuritë negative siç janë bullizimi dhe format e tjera. Kemi konstatuar që një numër i madh i rojeve që kanë qenë në shkolla nuk

kanë qenë të nevojshëm pas vendosjes së kamerave dhe të njëjtit i kemi vendos si punëtor teknik për t'i mirëmbajtur oborret të pastërta dhe për të krijuar ambient më të sigurt për nxënësit.

A kemi sfida, normalisht që kemi sfida dhe ende vazhdojnë të jenë sfidat, incidentet dhe zënkat mes nxënësve që është një proces që ndodh gjithë andej, lokalet afër shkollave edhe kjo është një sfidë që ballafaqohemi me të, po ashtu edhe qenët endacak, komunikacioni e kështu me radhë, mirëpo në koordinim me të gjitha organet relevante jemi të interesuar të krijojmë një ambient të sigurt, të qet për nxënësit dhe mbi të gjitha gjithëpërfshirës.

Unë ju falënderoj juve për të gjitha sugjerimet dhe këshillat që i japët, këto tema ne i trajtojmë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe ky debat e ka pasur këtë çështje e që unë do t'i përcjell në çdo organ dhe institucion këshillat dhe sugjerimet e juaja.

**znj.Edonë Shabani**, theksoi, nuk e di nëse drejtori i DKA-së e kishte fjalën për shkollën teknike, por sa i përket kësaj shkolle ne të gjithë i kemi dit problemet dhe numrin e problematikëve brenda në shkollë, kurse tani është problemi që nuk i njohim dhe nuk i dimë.

Sa i përket psikologeve është mirë që është rritur numri i tyre, por do të doja një përgjigje nga ana e jote drejtor se sa nxënës janë takuar me psikologun e shkollës, në qoftë se jeni në dijeni se a ka shkuar ndonjë nxënës të takohet me psikologun e shkollës, përndryshe unë të garantoj që asnjë nxënës dhe se arsyeja pse është që profesorët nuk i motivojnë, prandaj unë në emër timin personal të garantoj se asnjë nxënës nuk shkon të takohet me psikologun sepse psikologun e shohin si mjek për probleme mendore, mendojnë që nëse ne shkojmë aty shkolla mendon që kemi probleme, prandaj krejt kjo është e lidhur me këtë çështje, ndërsa më shumë janë arritje për ty krejt këto punësime të psikologeve dhe pedagogëve, mirëpo pyetja është sa probleme janë evituar nga këto punësime që kanë ndodhur.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, u përmend këtu edhe nga Kryetari i Komunës por edhe nga drejtori i DKA-së që tenderi për bartjen e nxënësve me aftësi të kufizuar ka shkuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit-OSHP, unë këtë çështje e kam përcjell dhe është ashtu dhe në OSHP ka shkuar për fajin e juaj, pra zyrës prokurimit, sepse kompanisë që kanë vendosur t'ia japin tenderin për bartjen e nxënësve nuk e ka plotësuar asnjë kusht të vetëm për bartjen e atyre nxënësve, nuk mundet nxënësi me aftësi të kufizuar që të kërcej dhe të hyjë në kombi, pra kam hyrë dhe i kam shikuar të gjitha problemet se pse ka shkuar ajo lëndë në OSHP, pra ka qenë një dallaver i madh aty ngase nuk mund t'ia japësh tenderin një autobusi për t'i bartur njerëzit me nevoja të veçanta pa e pasur vendin apo ulësen që atyre ju mundësohet hyrja me karrocë dhe se vendet e tyre brenda automjetit nuk i kanë për karroca, por janë me ulëse normale dhe për këto arsyeja ka shkuar në OSHP.

Pra duhet të tregohet problemi se pse kanë shkuar këta tender në OSHP sepse po bëhen dallavere brenda, përndryshe vetëm shihni dokumentet e operatorit që e ka fituar tenderin dhe atij që është ankuar, ky që është ankuar ka pasur të drejtë dhe është mirë që është ankuar. Mirëpo po ka raste që edhe po kanë frikë të ankohen sepse po ju bëhen presione që të mos ankohen, prandaj mendoj se është mirë dhe duhet të ankohet të gjithë sepse ai që i plotëson kushtet nuk ka lidhje që e ka çmimin më të lartë, pra në këtë rast i plotëson kushtet, e ka automjetin për bartjen e këtyre personave dhe duhet ti jepet tenderi, e jo a largojnë vetëm që është në parti tjetër dhe t'ia japin këtij që nuk e plotëson asnjë kusht.

**z.Haki Rudari**, theksoi, deshta të ndërlihem shumë shkurt me kolegën znj.Edonë Shabani e cila e tha trajtimi i nxënësve te psikologu, unë kam punuar në shkollën "Shaban Shala" dhe e di që ka pas disa raste që janë trajtuar, nxënës që kanë pas ndonjë problem ndonjë stres, të tillë që kanë qajtë nga ndonjë problem familjar apo mes vete e të ngjashme, beso se janë trajtuar ata nxënës, numrin e tyre nuk e di por po foli për diçka që është e sakt dhe që e di, kurse raste tjera sigurisht që ndoshta drejtori i DKA-së mund t'i cekë. Është shumë mirë që ka psikolog dhe këtë që e ceka e

kam të vërtetuar, për fshatin Shajkoc prej nga vije unë nuk ka sepse numri i nxënësve është më i vogël, mirëpo mund të them se psikologët nëpër shkolla kam parë që e kanë një rol shumë të mirë dhe shumë pozitiv në rastet kur ka të bëjë me ndonjë mosmarrëveshje mes veti, ndonjë problem, ndonjë stres apo diçka të ngjashme.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë. Vërtetë sot kam ardh me një vullnet shumë të madh dhe me shpresën që do të dalin rekomandime dhe ide se si të parandalojmë këto fenomene dhe këto dukuri negative e sidomos me insistimin e iniciueses për vazhdimin e kësaj seance e që me të vërtetë po shoh që kjo nuk i'a paska vlejtur.

Pra më lejoni të rikujtoj edhe njëherë masat të cilat unë kam propozuar që të merren për parandalimin e këtyre fenomeneve, ato janë si vijon;

- Duke pasë parasysh që në bazë të statistikave të cilat na i ka dërguar Policia e Kosovës, pra po foli për statistika zyrtare dhe linja zyrtare të komunikimit ngase unë vetë i kam kërkuar dhe jua kam dërguar juve, duke u bazuar në ato statistika rezulton se pjesa më e madhe fëmijëve, të rinjve apo adoleshentëve delikuent që shkaktojnë dhunë janë ata të cilët vijnë në klasën e V-të deri në Klasën e IX-të, dhe bazuar në këtë fakt unë kam propozuar që të hyjnë edhe uniforma edhe në shkollat fillore (nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë), kjo do të ndihmonte uniformimin e nxënësve, trajtimin e tyre të gjithë si të barabartë si dhe do të ndihmonte në ndasitë shtresore apo barazitë sociale të cilat mund t'i kenë fëmijët e këtyre grupmoshave

- Tjetra është kontrolle të vazhdueshme rutinore nëpër shkolla, vlen të potencohet që pra mbi 2000 kontrolle i ka realizuar Policia e republikës së Kosovës në dhe rreth shkollave, mirëpo është shumë e rëndësishme që edhe stafi i brendshëm të bëjë kontrolle të tilla.

- Trajtim ligjor dhe psikologjik i të rinjve problematik si dhe shtim i stafit lokal, duke përfshirë këtu psikologët dhe punonjësit social në përputhje me Ligjin për familjen dhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijës.

- Fushata informuese më të detajuara.

- Projekte konkrete në fushën e rinisë nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe bashkëpunim dhe koordinim më i madh me OJQ reale që veprojnë në Komunën e Podujevës.

- Përkrahje më e madhe e projekteve konkrete gjatë tërë vitit në fushën e rinisë si dhe matje e rezultateve të projekteve. Jemi dëshmitar të dhënies së disa projekteve të cilat jepen për të stimuluar ose për të përkrahur fushën e rinisë mirëpo fatkeqësisht nuk jemi duke i matur rezultatet ose nuk shihen rezultatet se çka bëjnë ata me këto çështje.

- Respektim i ligjit duke kufizuar qasjen e të rinjve dhe adoleshentëve në blerjen e duhanit dhe alkoolit, pra si Komunë të gjitha dyqaneve dhe lokaleve afariste që t'i bëjë vërejtje dhe t'jua bëjë obligative që përdorimi i duhanit dhe alkoolit është vetëm për një moshë të caktuar dhe nuk vlen për të gjitha moshat.

- Trajtimi i familjeve prej nga vijnë të rinjtë problematik nga ana e Qendrës për Punë Sociale-QPS, është shumë e rëndësishme që akteri tjetër shumë i rëndësishëm në nivel shoqëror që janë QPS e cila duhet të përfshihet sa më shumë dhe së bashku me institucionin e shkollës dhe institucionet edukativo arsimore. Pra në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe me organet tjera relevante t'i trajtojnë familjet prej nga vijnë fëmijët problematik.

- Dhe së fundmi kemi disa iniciativa sidomos prej Drejtorisë së Arsimit e cila kam parë që bënë organizime të ndryshme rekreative sportive të nxënësve, mirëpo unë sugjeroj që organizime dhe aktivitete të tilla të bëhen rutinore mbi baza mujore në mënyrë që të rinjtë të kenë mundësi të merren edhe me aktivitete të tjera krahas aktiviteteve obligative shkollore.

Pra unë kam menduar se këto janë disa nga çështjet me të cilat duhet të merremi më seriozisht ose që Ekzekutivi i Komunës duhet të merret më seriozisht me qëllim që ti minimizojmë këto

fenomene negative në shoqërinë tonë, si dhe duke inkorporuar edhe propozimet të cilat i bërën kolegët asambleistë përfshirë këtu edhe kolegun z.Xhevdet Malokun, është mir që këto të bashkëngjiten si pjesë e një deklaratë dhe këto rekomandime t'i përcillen edhe Këshillit Komunal për Siguri në bashkësi si dhe Drejtorive përkatëse në mënyrë që në vitin që po hyjmë të jetë një vit më i mirë, me më pak fenomene negative, më pak përdorim të armëve të ftohta dhe atyre të zjarrit sidomos nga të rinjtë tanë.

**znj.Edonë Shabani**, theksoi, deshta t'i them kolegut parafolës (i drejtohet z.Haki Rudarit) ngase u nënkuptova pak si keq, unë nuk jam kundër psikologëve, përkundrazi është shumë e mirë për shkollën që të ketë psikolog, por problemi është që duhet t'ju tregohet nxënësve dhe fëmijëve nëpër shkollë që nuk është marre të shkohet te psikologu. Unë e kam frikën se sa funksionin me fëmijë psikologu nëpër shkollë, pra duhet t'ju tregohet se duhet të shkohet të bisedohet me psikologët sepse nuk është marre të tregohen hallet e të ngjashme dhe t'ju tregohet atyre se ato çështje mbeten personale dhe nuk shfaqen në shkollë dhe nuk bëhen publike, prandaj për këtë deshta të tregoj se ky është problemi i vetëm që e konsideroj unë.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, nuk do ta doja të replikoj por kolegu z.Ragip Fetahu nganjëherë din të kritikoj por vetën nuk e shef fare. Kur e bëri raportimin Kryetari i Komunës diti shumë t'i drejtohet opozitës duke i thënë hapeni veshët dhe dëgjoni mirë, mirëpo ky vet kur fola unë në këtë pikë të rendit të ditës si duket nuk paska hapë veshët dhe nuk paska dëgjuar fare, andaj ky vet paska nevojë t'i hap veshët.

Unë i propozova 4 pika / rekomandime shumë konkrete se çka duhet të bëjë Komuna si institucion, po kolegu nuk e ka dëgjuar, prandaj nëse po dëshiron t'i përsërisë sërish i nderuar Fetahu, unë edhe po e bëjë.

-thash që të ketë organizime sa më të fuqishme që sa më shumë të ketë fushata profesioanle dhe vetëdijesuese në këto aspekte.

-Thash që kjo Komunë të krijoj shumë më shumë hapësira të sigurta për të rinjtë që do të merren em aktivitete kreative në mënyrë që t mos i'u lëm hapësirë ata kohën e tyre të lirë ta qojnë në dukuri negative.

-Thash që kjo Komunë ë bëjë programe për këshillime profesionale, do të thotë të trajtoj ende më shumë ata psikologë për t'i trajtuar të rinjtë nëpër shkollë me probleme të drogave,

-Thash që duhet të sigurohet shumë më shumë mbështetje për shkollat për t'i trajtuar konfliktet për të siguruar një mjedis të sigurt për ata.

Kështu të lutem i nderuar kolegë, kur të thuash neve hapeni veshët, fillimisht drejtohu vetës.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, vetëm deshta një plotësim kolegut tim z.Ragip Fetahu, debati nuk mund të quhet që nuk i'a ka vlejte, përkundrazi i'a ka vlejtur shumë dhe të falënderojmë ty shumë që e ke iniciuar këtë temë mjaft të qëlluar dhe të rëndësishme, përndryshe pati disa propozime konkrete prej dy-tre asambleistëve kështu që çdo propozim qoftë një qoftë më shumë është shumë i nevojshëm për t'i trajtuar dhe për të vazhduar përpara.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë i kam njoftuar të gjitha Drejtoritë, materiali i'u ka shkuar të gjithëve me kohë e që ndoshta është dashur edhe ndokush nga Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB të jetë prezent për të raportuar, por Komandanti i Policisë raporton në KKSB.

Ne e kërkuam në mbledhjen e kaluar që raportimi i Komandantit të Policisë të raportoj në muajin janar 2025 dhe atë e futëm si pikë në Planin e punës së Kuvendit.

Unë e përkrahi shumë këtë iniciativë të z.Ragip Fetahut , besoj që debati u shterr për këtë temë dhe diskutimet ishin të gjitha në nivel dhe me qëllimin më të mirë që ky projekt të përkrahet, kështu që rekomandimet e çdo anëtari të Kuvendit që i bënë do të doja të jenë pjesë e Deklaratës në fjalë duke i'u bashkëngjitur atyre të zotëri Fetahut, në mënyrë që përmes kësaj edhe institucionet

përgjegjëse t'i bëjmë edhe më të përgjegjshme edhe pse besoj që ato i kanë kryer të gjitha obligimet që kanë sa i përket këtyre çështjeve, mirëpo nuk do të thotë që nuk ka vend edhe për rekomandime shtesë tjera, prandaj i hedh në votim që këto rekomandime të mbështeten dhe të bëhen pjesë e një Deklaratës të cilën e hedh në votim.

*Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 20 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, mbështeten Deklarata së bashku me rekomandimet e propozuara nga iniciuesi i kësaj pike të rendit të ditës si dhe rekomandimet tjera të propozuara nga anëtarë/e të Kuvendit të Komunës gjatë diskutimeve, dh atë si në vijim:*

#### DEKLARATË

*Kuvendi i Komunës së Podujevës, përmes kësaj Deklarate rekomandon që Komuna e Podujevës / Drejtoritë komunale (me theks Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit) në bashkëpunim edhe me të gjitha organet dhe institucionet tjera përkatëse, të ndërmarrin masa konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, në funksion të zgjidhjes së problemeve të kësaj natyre dhe atë duke filluar që nga viti i ardhshëm, me qëllim të interesit të përgjithshëm dhe ruajtjes së një rinie të shëndosh.*

*Rekomandimet e mbështetura janë:*

- *Uniforma edhe në shkollat fillore (nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë)*
- *Takime të shpeshta ndërmjet Këshillit të prindërve, Drejtorëve të shkollave dhe Këshillit të nxënësve.*
- *Kontrolle të vazhdueshme rutinore nëpër shkolla dhe ndihmë nga stafi i brendshëm i shkollave.*
- *Trajtim ligjor dhe psikologjik i të rinjve problematik si dhe shtim i stafit lokal, duke përfshirë këtu psikologët dhe punonjësit social në përputhje me Ligjin për familjen dhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijës.*
- *Fushata informuese më të detajuara.*
- *Projekte konkrete në fushën e rinisë nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe bashkëpunim dhe koordinim më i madh me OJQ reale që veprojnë në Komunën e Podujevës.*
- *Përkrahje më e madhe e projekteve konkrete gjatë tërë vitit në fushën e rinisë si dhe matje e rezultateve të projekteve.*
- *Respektim i ligjit duke kufizuar qasjen e të rinjve dhe adoleshentëve në blerjen e duhanit dhe alkoolit.*
- *Trajtimi i familjeve prej nga vijnë të rinjtë problematik nga ana e Qendrës për Punë Sociale.*
- *Organizime dhe aktivitete rekreative - sportive rutinore në baza mujore me qëllim të mundësisimit të shkarkimit të energjisë së të rinjve.*
- *Rritje e numrit të psikologëve në shkolla.*
- *Shtim dhe punësim i sigurimit fizik të trajnuar, sidomos në shkollat e mesme të qytetit.*
- *Pajisje e stafit të shkollës me detektor të metaleve në mënyrë që gjatë hyrjes së nxënësve të bëhen kontrolle me detektor të metaleve,*
- *Trajtim i bullizmit, si fenomen në rritje në shkollat tona. Vendosi e posterëve anti bullizëm nëpër korridore dhe hapësira tjera të shkollave në mënyrë që të ngritet vetëdija e fëmijëve dhe nxitja e tyre për raportim të rastet e tilla dhe kundër kësaj dukurie.*
- *Pajisje me bexh /kartel identifikuese për gjithë stafin e shkollave dhe vizitorët nëpër shkolla (përveç uniformave të nxënësve, mësimdhënësve dhe stafit tjetër)*
- *Organizim më i fuqishëm institucional në mënyrë që të ketë sa më shumë fushata vetëdijesuese në këto aspekte.*
- *Komuna e Podujevës të angazhohet në krijimin sa më shumë të hapësirave të sigurta për të rinjtë që do të merren me aktivitete kreative.*
- *Komuna e Podujevës të bëjë programe për këshillime profesionale që nënkupton trajnime shtesë për psikologët të cilët trajnojnë të rinjtë nëpër shkolla*
- *Sigurim shumë më shumë në shkolla me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt nëpër shkolla.*

*Rekomandimet e parapara me këtë Deklarata i'u përcillen Drejtorive përkatëse, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe organeve dhe institucioneve tjera relevante varësisht fushës së veprimit të tyre.*

### **3. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë**

*(NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi)*

**z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH,** theksoi, siç e keni edhe në materialin përkatës që ju është dërguar, Kryetari i Komunës ka nxjerrë një propozim vendim me të cilin përcakton kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale-NPL në Komunën e Podujevës e që ka të bëjë me NPL “Stacioni i Autobusëve” NPL për Banim dhe NPL “Eko-Llapi”. Jeni në dijeni se më parë është nxjerrë një vendim i cili ka pas të bëjë me kompensimin e komisionit të aksionarëve të NPL “Eko-Llapi”, mirëpo me miratimin e këtij vendimi që e kemi për shqyrtim tani dhe hyrjen në fuqi të tij, anulohet ai vendim nr.prot.01-400/01-0033737/24 i datës 23 maj 2024.

**znj.Qëndresë Hajrizi,** theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokal.

**znj.Donjetë Sheqiri,** theksoi, meqë në fillim të këtij mandati me shumicë të votave nga koalicioni juaj keni votuar përjashtimin tonë nga komisionet në këto ndërmarrje, andaj ne tani jemi kundër këtij propozim vendimi. Ashtu siç na keni përjashtuar atëherë, ashtu po i’u përjashtojmë edhe ne.

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, shikoni të nderuar anëtarë/e të Kuvendit, debati nuk mund të vazhdoj me ata që janë në konflikt interesit dhe janë prezent, andaj duhet ta lirojnë sallën. Pra ky ishte njoftim para se të jap fjalën të tjerëve.

**z.Naim Çunaku,** theksoi, nga ajo që e potencoj znj.Donjetë Sheqiri është e vërtetë se në seancën e Kuvendit të datës 27 mars 2021 nëse nuk gaboj, Grupi i këshilltarëve të LDK-së është i përjashtuar nga të qenurit në komisionet e aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike dhe si rrjedhojë e kësaj nuk i japim vetës të drejtë të jemi ata që vendosim për diçka që jemi të përjashtuar, mirëpo parasë të ndodh kjo më bëri t’i them edhe disa fjalë për atë që e dëgjova nga propozuesi apo drejtori parafolës z.Bahri Selimi i cili e potencoj se Kryetari i Komunës e ka nxjerrë një propozim vendim për pagesën e këtyre komisioneve të Ndërmarrjeve Publike Lokale, unë edhe tani kam dyshimet e mia që a mundet një autoritet të nxjerrë vendim për pagesën që duhet ta bëjë autoriteti tjetër, si dhe edhe unë mendoj që edhe baza ligjore e kësaj nuk e kam të kjartë sa jemi kompatibil me Ligjin për Ndërmarrjet Publike ngase nuk mund të nxjerrët një vendim nga një instancë tjetër dhe instanca tjetër të bëjë pagesë, mirëpo sidoqoftë mbetemi në atë që e potencoj znj.Donjetë Sheqiri në emër të Grupit të LDK-së dhe nuk do të jemi pjesë e vendimmarrjes në këtë proces.

*Grupi i LDK-së lëshon seancën/sallën me arsyetimin siç e cekën, ndër të tjera, në kohën kur janë themeluar këto komisione të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale, Grupi i LDK-së është përjashtuar në një formë të kenë përfaqësuesit e vet në këto Komisione, andaj si shkas i kësaj nuk do të jenë pjesë e këtij procesi tani.*

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, meqë tani prezent në sallë janë vetëm 13 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës dhe rrjedhimisht kuorumi nuk ekziston për të vazhduar tutje, kjo pikë e rendit të ditës mbetet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Prandaj këtë mbledhje e shpallim të mbyllur.



*Konstatim:*

*Meqë nga numri përgjithshëm prej 35 anëtarëve të Kuvendit të Komunës, prezent në sallë janë vetëm 13 prej tyre, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se në mungesë të kuorumit mbledhja nuk mund të vazhdoj tutje dhe mbyllet këtu, ndërsa për këtë pikë (pika 5) të mbetur në gjysmë sugjeron që të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:20**

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0082569/24  
Podujevë,  
30 dhjetor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha**